



L I G J I

NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME MBI BANKA ¹

KAPITULLI I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Lënda e rregullimit

Neni 1

Me këtë ligj rregullohen:

- rregullat, procedura dhe instrumentet për ndërhyrjen e jashtëzakonshme mbi personat e nenit 2, paragrafi (1);
- autorizimet dhe përgjegjësitë e Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut si organ për ndërhyrje të jashtëzakonshme si dhe autorizimet dhe përgjegjësitë e organeve dhe personave të tjerë në lidhje me ndërhyrjen e jashtëzakonshme mbi personat e nenit 2, paragrafi (1) të këtij ligji dhe;
- themelimi, financimi, përdorimi i mjeteve dhe drejtimi i Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme mbi Bankat.

Zbatimi i ligjit

Neni 2

(1) Ky ligj zbatohet mbi:

- 1) banka me leje për themelim dhe funksionim të lëshuar nga Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejme: Banka Popullore);
- 2) institucion financiar me seli në Republikën e Maqedonisë së Veriut që është filial i personave të pikës 1) dhe 3) të këtij paragrafi dhe është e përfshirë me mbikëqyrjen e atyre personave në bazë të konsoliduar, në përputhje me ligjin që rregullon funksionimin e bankave dhe
- 3) shoqëri tregëtare financiare, holding shoqëri financiare e përzier ose shoqëri tregëtare me aktivitete të përziera me seli në Republikën e Maqedonisë së Veriut, i cili është person amë i personit të pikës 1) të këtij paragrafi.

(2) Ky ligj nuk vlen për Bankën e Zhvillimit të Maqedonisë së Veriut.

(3) Mbi bankën në të cilën zhvillohen aktivitete për ndërhyrje të jashtëzakonshme, zbatohet ligji i cili rregullon punën e bankave dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij, përveç nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

¹ Ky ligj është në përputhje me Direktivën 2014/59/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 15 maj 2014, për krijimin e një kuadri për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjes së jashtëzakonshme e institucioneve të kreditit dhe të firmave të investimeve dhe për ndryshimin e Direktivës 82/891 / EEC, dhe Direktivat 2001/24/EC, 2002/47/EC, 2004/25/EC, 2005/56/EC, 2007/36/EC, 2011/35/EU, 2012/30/EU dhe 2013/36 / BE, dhe

Rregulloret (BE) nr. 1093/2010 dhe (BE) nr. 648/2012, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit (CELEX 32014L0059)

Përkufizime

Neni 3

Disa nga shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

- 1) "Veprimtari për ndërhyrje të jashtëzakonshme" është marrja e një vendimi për fillimin e procedurës së ndërhyrjes së jashtëzakonshme mbi bankën, zbatimi i instrumenteve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme mbi bankat ose zbatimi i autorizimeve për ndërhyrje të jashtëzakonshme ndajbankave;
- 2) "Aksionarë" janë pronarë të aksioneve ose zotërues të instrumenteve të tjera të pronësisë;
- 3) "Bankë" ka kuptimin e përcaktuar në ligjin që rregullon funksionimin e bankave;
- 4) "Bankë ku bëhet ndërhyrja e jashtëzakonshme " është banka ndaj së cilës ndërmerren veprime për ndërhyrje të jashtëzakonshme ndaj saj, të parashikuar me këtë ligj;
- 5) "Grup bankash" ka kuptimin e përcaktuar në ligjin që rregullon veprimtarinë e bankave;
- 6) "Shuma totale e shtresave mbrojtëse të kapitalit" ka kuptimin e përcaktuar në ligjin që rregullon veprimtarinë e bankave;
- 7) "Ndihmë e jashtëzakonshme financiare publike" është ndihma shtetërore në kuptimin e rregulloreve që rregullojnë përdorimin e ndihmës shtetërore që jepet për qëllime të mirëmbajtjes ose rivendosjen e qëndrueshmërisë, likuiditetit ose aftësisë e pakesës të një banke;
- 8) "Linjat kryesore tregëtare" janë ato linja të tregëtisë dhe shërbimet që lidhen me to, të cilat përfaqësojnë një burim të rëndësishëm të ardhurash ose fitimi të bankës ose të grupit të cilit banka i përket;
- 9) "Grupi" ka kuptimin e përcaktuar në ligjin që rregullon veprimtarinë e bankave;
- 10) "Grupi për ndërhyrje të jashtëzakonshme" paraqet bartësin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe filialet e tij që nuk konsiderohen për bartës të ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe që nuk janë filiale të një bartësi tjetër për ndërhyrje të jashtëzakonshme;
- 11) "Kontratë për sigurimin financiar me kalimin e pronësisë" kuptimin e ka të përcaktuar me ligjin që rregullon sigurimin financiar;
- 12) "Kontratë për sigurimin financiar me të drejtë pengu" kuptimin e ka të përcaktuar me ligjin që rregullon sigurimin financiar;
- 13) "Kontratë/deklaratë kompensimi" është një kontratë/deklaratë me të cilën banka ndaj të cilës bëhet ndërhyrje e jashtëzakonshme dhe një palë tjetër kontraktuese kompensojnë dy ose më shumë hua ose dy a më shumë detyrime;
- 14) "Detyrime të lejuara" janë detyrimet e përcaktuara sipas nenit 11 të këtij ligji;
- 15) "Instrumente huamarrëse" janë obligacionet dhe format e tjera të huamarrjes transferuese, instrumente të cilat krijojnë ose njohin huamarrjen dhe instrumente të cilat japin të drejtën për të fituar instrumente të huamarrjes;
- 16) "Hua shtesë për kapital" nënkupton nivelin më të lartë të normës së rregullt të kapitalit bazë, normës së kapitalit bazë dhe/ose normës përkatëse të kapitalit të përcaktuar nga Banka Popullore në përputhje me ligjin që rregullon punën e bankës;
- 17) "Shoqëri pranuese" ose "blerëse" është personi juridik të cilit i janë transferuar ose shitur aksione, instrumente të tjera pronësie, instrumente huamarrje, të drejta ose detyrime nga banka ndaj të cilës bëhet ndërhyrje e jashtëzakonshme;
- 18) "Autoriteti i vetëm për ndërhyrje të jashtëzakonshme" (Single Resolution Board) është autoriteti përgjegjës për ndërhyrje të jashtëzakonshme ndaj institucioneve të kreditit në BE.

19) "Kreditor i prekur" është kreditori, huaja e të cilit nga banka është reduktuar ose konvertuar në aksione ose instrumente të tjera pronësie, nëpërmjet zbatimit të autorizimit të shlyerjes ose shëndrrimit gjatë aplikimit të shpërndarjes së brendshme të humbjeve;

20) "Shoqëri investimi" ka kuptimin e përcaktuar në ligjin që rregullon instrumentet financiare;

21) "Pjesëmarrje e kualifikuar në bankë" ka kuptimin e përcaktuar në ligjin që rregullon veprimtarinë e bankave;

22) "Bazë e konsoliduar" ka kuptimin e përcaktuar në ligjin që rregullon veprimtarinë e bankave;

23) "Institucion kreditor" ka kuptimin e përcaktuar në ligjin që rregullon veprimtarinë e bankave;

24) "Funksione kritike" janë aktivitetet, shërbimet dhe çështjet që nëse ndalojnë së kryeri, mund të çojnë në prishjen e stabilitetit financiar ose në ndërprerjen e shërbimeve të nevojshme për sektorin real, për shkak të madhësisë, pjesës së tregut, lidhjes së bankës me persona të tjerë në sektorin financiar, kompleksitetin ose aktivitetet ndërkufitare të bankës ose grupit të cilit i përket banka, veçanërisht për sa i përket zëvendësueshmërisë së këtyre aktiviteteve, shërbimeve dhe çështjeve;

25) "Mbështetje likuiditeti në rrethana të jashtëzakonshme" është dhënia e mbështetjes së likuiditetit nga Banka Popullore ose çfarëdo ndihme tjetër, si rezultat i së cilës mund t'i ofrohet mbështetje likuiditetit nga Banka Popullore një bankë tretëse e cila përballet me probleme të përkohshme të likuiditetit, në përputhje me Ligjin për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut;

26) "Persona me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta" ka kuptimin e përcaktuar në ligjin që rregullon veprimtarinë e bankave;

27) "Klient i vogël" është klienti i një shoqërie investuese ose banka që ofron shërbime dhe aktivitete investuese dhe që nuk i plotëson kushtet për klient profesionist, ndërsa në Republikën e Maqedonisë së Veriut siç është e rregulluar me ligjin që rregullon instrumentet financiare;

28) "Person amë" ka kuptimin e përcaktuar në ligjin që rregullon veprimtarinë e bankave;

29) "Masa për parandalimin e krizës" janë masat për heqjen e mangësive ose kufizimeve për zbatimin e planit të rimëkëmbjes dhe/ose masat për ndërhyrje të hershme, në përputhje me ligjin që rregullon veprimtarinë e bankave, masat për heqjen e pengesave për ndërhyrje të jashtëzakonshme në përputhje me nenin 9 të këtij ligji dhe aplikimin e autorizimit për shlyerjen ose shëndrrimin e instrumenteve përkatëse kapitale dhe detyrimeve të lejuara nga Kapitulli IV të këtij ligji;

30) "Masa për menaxhimin e krizave" janë veprimet për ndërhyrje të jashtëzakonshme ndaj këtij ligji, emërimi i drejtuesve të posaçëm në përputhje me nenin 23 të këtij ligji ose i personave në përputhje me nenin 40, paragrafi (1) dhe nenin 59, paragrafi (2) të këtij ligji;

31) "Shoqëri e përzier financiare" ka kuptimin e përcaktuar në ligjin që rregullon veprimtarinë e bankave;

32) "Mundësia për ndërhyrje të jashtëzakonshme ndaj një banke" është një mundësi për të zbatuar procedurat e falimentimit ndaj bankës ose për të kryer veprimtari të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, në përputhje me kushtet e nenit 8 të këtij ligji;

33) Organi kompetent për mbikëqyrje" është autoritet i autorizuar me ligj për mbikëqyrjen e institucioneve kreditore dhe/ose shoqërive investuese. Në Republikën e Maqedonisë së Veriut autoriteti kompetent për mbikëqyrjen e bankave është Banka Popullore;

34) "Organi kompetent për super mbikëqyrjen në bazë të konsoliduar" ka kuptimin e përcaktuar në ligjin që rregullon veprimtarinë e bankave;

35) "Organi kompetent për ndërhyrje të jashtëzakonshme" është organ i autorizuar me ligj për ndërhyrje të jashtëzakonshme ndajbankave, respektivisht për ndërhyrje të jashtëzakonshme ndajinstitucioneve të kreditore dhe institucioneve jera financiare;

36) "Bartës i ndërhyrjes së jashtëzakonshme" është banka për të cilën plani për ndërhyrje të jashtëzakonshme nga nenet 5 ose 6 të këtij ligji parashikon ndërmarrjen e veprimeve për ndërhyrje të jashtëzakonshme ose person juridik me seli në Republikën e Maqedonisë së Veriut për të cilin në planin për ndërhyrje të jashtëzakonshme së grupit bankar të nenit 7 të këtij ligji parashihet ndërmarrja e veprimeve për ndërhyrje të jashtëzakonshme ;

37) "Neting marrëveshje" është një marrëveshje sipas së cilës huat ose detyrimet e shumta mund të shndërrohen në një kërkesë të vetëm neto, i cili përfshin dispozitat e mbylljes së netos, ku me paraqitjen e ngjarjes së performancës (pavarësisht si është përcaktuar), detyrimet e palëve kontraktuese bëhen të menjëhershëm ose ndërpriten, dhe në çdo rast shëndërrohen në një borxh të vetëm neto, duke përfshirë "kompensimin" në përputhje me ligjin që rregullon sigurinë financiare dhe "netingun" në përputhje me ligjin që rregullon shërbimet e pagesave dhe sistemet e pagesave;

38) "Detyrime për shpërndarjen e brendshme të humbjeve" janë detyrimet dhe instrumentet kapitale që nuk plotësojnë kushtet për t'u përfshirë në kapitalin bazë të rregullt, kapitalin bazë shtesë dhe kapitalin shtesë të bankës dhe që nuk përjashtohen nga objekti i shpërndarjes së brendshme të humbjeve në përputhje me këtë ligj;

39) "Detyrime të siguruara" janë detyrimet në të cilat e drejta e kreditorit për mbledhjen ose një formë tjetër përmbushjeje sigurohet me tarifë, barrë ose një kontratë sigurie financiare, duke përfshirë detyrimet që rrjedhin nga kontrata repo dhe kontratat e tjera për sigurinë financiare me kalimin e pronësisë;

40) "Operator i sistemit të pagesave" ka kuptimin e përcaktuar në ligjin që rregullon shërbimet e pagesave dhe sistemet e pagesave;

41) "Depozita të pranueshme" janë depozitat që i nënshtrohen sigurimit në përputhje me ligjin që rregullon sigurimin e depozitave;

42) "Mjete monetare dhe mjete të tjera të një klienti" janë mjetet monetare dhe mjete të tjera të një klienti të bankës që ajo mban ose administron në emër dhe për llogari të klientit;

43) "Degë" ka kuptimin e përcaktuar në ligjin që rregullon veprimtarinë e bankave;

44) "Depozita të mbuluara" janë depozitat e pranueshme që nuk e kalojnë kufirin e kompensimit në përputhje me ligjin që rregullon sigurimin e depozitave;

45) "Obligacionet të mbuluara" janë obligacionet të huamarrjeve të mbuluara nga ekspozimet që janë pjesë e mjeteve të bankës. Blerësit e obligacioneve të mbuluara kanë përparësi në mbledhjen e pretendimeve mbi bazën e të cilave janë lëshuar obligacionet të mbuluara në rast se emetuesi i detyracionit nuk i përmbush detyrimet e tij.

46) "E drejta për ndërhyrje të jashtëzakonshme kontrate" është e drejta për të ndërprerë ose anuluar një kontratë, përmbushje të parakohshme ose shlyerje të detyrimeve dhe çdo dispozitë e ngjashme që heq, ndryshon ose shuan një detyrim të palës kontraktuese ose një dispozitë që parandalon shfaqjen e ndonjë detyrimi i cili përndryshe do të mund të lind nga kontrata;

47) "Rregulloret për përdorimin e ndihmës shtetërore" janë ligji i cili rregullon kontrollin e ndihmës shtetërore në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe aktet tjera që zbaton Komisioni për mbrojtjen e konkurrencës në kontrollin e ndihmës shtetërore;

48) "Profili i rrezikut" është një paraqitje sasiore dhe/ose cilësore e nivelit të rreziqeve të matshme dhe të pamatshme që banka ndërmerr në operacionet e saj, të përcaktuar në përputhje me ligjin që rregullon punën e bankave;

49) "Ditë pune" është çdo ditë përveç së shtunës, të dielës dhe festave shtetërore në përputhje me ligjin me të cilin rregullohen festat në Republikën e Maqedonisë së Veriut;

50) "Ndërhyrje e jashtëzakonshme" është aplikimi i një ose më shumë instrumenteve për ndërhyrje të jashtëzakonshme për realizimin e një ose më shumë qëllimeve të nenit 17 të këtij ligji;

51) "Procedurë falimentimi" është një procedurë që përfshin shitjen e plotë ose të pjesëshme ose monetarizimin e pasurisë së debitorit dhe caktimit të një administruesi falimentimi ose likuiduesi, i cili zbatohet për një bankë, në përputhje me ligjin që rregullon veprimtarinë e bankave, me përjashtim të procedurës të likuidimit të rregullt;

52) "Bankë e huaj" ka kuptimin e përcaktuar në ligjin që rregullon veprimtarinë e bankave;

53) "Instrumentet e përshtatura kapitale" për qëllimet e Kapitullit III, njësia 2 seksioni 5 dhe Kapitulli IV nga ky ligj, janë instrumentet e kapitalit bazë shtesë dhe instrumentet e kapitalit shtesë;

54) "Instrumentet pronësore" janë aksionet e një banke, instrumente që mund të konvertohen në aksione ose të japin të drejtën për të blerë aksione ose instrumente që përfaqësojnë pronësinë e aksioneve ose instrumenteve të tjera pronësie;

55) "Mjete pronësore" kanë kuptimin e përcaktuar në ligjin që rregullon veprimtarinë e bankave;

56) "Norma e konvertimit" është norma me të cilën detyrimet e një kategorie të caktuar konvertohen në një numër të caktuar aksionesh ose instrumente të tjera pronësie;

57) "Filial" ka kuptimin e përcaktuar në ligjin që rregullon veprimtarinë e bankave;

58) "Krizë financiare" ka kuptimin e përcaktuar në ligjin që rregullon stabilitetin financiar; 59) "Derivatë financiarë" janë instrumente financiare derivative të përcaktuara në ligjin që rregullon instrumentet financiare;

60) "Kontrata financiare" janë këto lloje kontratash dhe transaksionesh:

a) kontrata për obligacionet, duke përfshirë:

-kontrata për blerjen, shitjen ose huadhënien e një letre me vlerë, grupë ose indeks letrash me vlerë;

-mundësi për letra me vlerë, grupë ose indeks letrash me vlerë;

-transaksione repo ose transaksione të anasjellta të repove të çdo letre të tillë, grupë ose indeks letrash me vlerë;

b) kontratë për mallra, duke përfshirë:

-kontrata për blerjen, shitjen ose huadhënien e mallrave, grupin ose indeksin e mallrave për dorëzim në të ardhmen;

-opcionet e indeksit të mallit, grupit ose mallit;

-transaksione repo ose transaksione repo të anasjellta të ndonjë prej këtyre mallrave, grupeve ose indekseve;

c) kontratë swap, duke përfshirë:

- swap dhe mundësi që lidhen me normat e interesit, transaksionet spot dhe transaksionet e tjera të tregut të devizave, valuta, instrumente pronësore dhe indeks të instrumenteve pronësore, instrumente borxhi dhe indeks të instrumenteve të borxhit, mallra dhe indeks mallrash, kushte meteorologjike, njësi emetimi ose inflacion,

- kthim të plotë, zbrazëtirë kreditore ose swape kreditore,
- çdo marrëveshje ose transaksion i ngjashëm me marrëveshjet dhe transaksionet e pikës së parë dhe të dytë të këtij nënparagrafi që tregtohen periodikisht në tregjet e swapeve ose të derivateve
- ç) kontrata për hua ndërbankare nëse afati i huas është tre muaj ose më pak;
- d) kontratat kornizë për çdo kontratë ose transaksion nga nënpikat a) deri në e) të kësaj pike.
- 61) "Institucion financiar" kuptimin e ka të përcaktuar në ligjin që rregullon veprimtarinë e bankave;
- 62) "Shoqëri tregëtare financiare" kuptimin e ka të përcaktuar në ligjin që rregullon veprimtarinë e bankave;
- 63) "Fondi i sigurimit të depozitave" është fondi i themeluar me ligjin që rregullon sigurimin e mbrojtjes të depozitave;
- 64) "Fondi për ndërhyrje të jashtëzakonshme" është fondi i themeluar në përputhje me nenin 72 të këtij ligji;
- 65) "Shoqëri holding me veprimtari të përzier" kuptimin e ka të përcaktuar në ligjin që rregullon shërbimet e pagesave dhe sistemet e pagesave;
- 66) "Pala tjetër qendrore" kuptimin e ka të përcaktuar në ligjin që i rregullon shërbimet dhe sistemet pagesore.

Organi kompetent

Neni 4

(1) Banka Popullore është organi kompetent për ndërhyrjen e jashtëzakonshme mbi bankat Republikën e Maqedonisë së Veriut.

(2) Banka Popullore është autoriteti kompetent për ndërhyrjen e jashtëzakonshme mbi grupet bankare në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

(3) Banka Popullore themelon organizim të brendshëm të përshtatshme me qëllim sigurimin e pavarësinë operative dhe për të parandaluar konfliktin e interesave gjatë kryerjes së punëve si organ kompetent për ndërhyrje të jashtëzakonshme ndajbankave (funksioni i ndërhyrjes së jashtëzakonshme të bankave) në përputhje me këtë ligj dhe veprimet si një organ kompetent për super mbikëqyrje (funksion super mbikëqyrës) në përputhje me ligjin që rregullon veprimtarinë e bankave. Funksioni i ndërhyrjes së jashtëzakonshme të bankës dhe funksioni super mbikëqyrës kryhen nëpërmjet dy njësive të veçanta organizative të Bankës Popullore.

(4) Të punësuarit në Bankën Popullore nga dy njësitë organizative bashkëpunojnë me njëritjetrin në procedurat e planifikimit, përgatitjes dhe realizimit të aktiviteteve për ndërhyrje të jashtëzakonshme ndajbankave.

(5) Banka Popullore me akt të brendshëm më hollësisht e përcakton mënyrën e bashkëpunimit të njësive të veçanta organizative të paragrafit (4) të këtij neni.

KAPITULLI II
AKTIVITETE PËRGATITORE PËR NDËRHYRJE TË JASHTËZAKONSHME MBI BANKA

Pjesa 1
Planet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme

Plani për ndërhyrje të jashtëzakonshme mbi bankë

Neni 5

(1) Banka Popullore përgatit plan për ndërhyrje të jashtëzakonshme për secilën bankë që nuk është pjesë e grupit bankar, i cili i përmban aktivitete për ndërhyrje të jashtëzakonshme që Banka Popullore mund t'i ndërmarrë nëse banka i plotëson kushtet për ndërhyrje të jashtëzakonshme të nenit 19, paragrafi (1) të këtij ligji.

(2) Banka Popullore në planin për ndërhyrje të jashtëzakonshme parasheh skenarë në të cilët banka pushon së funksionuari si rezultat i rrethanave të lidhura me bankën e caktuar ose si rezultat i jostabilitetit ose rrethanave të tjera të pafavorshme në sistemin financiar.

(3) Plani për ndërhyrje të jashtëzakonshme rishikohet dhe nëse është e nevojshme, përditësohet të paktën një herë në vit, si dhe në rast të ndryshimeve të rëndësishme në strukturën organizative, politikën afariste ose gjendjen financiare të bankës ose në rast të ndryshimeve të tjera që mund të ndikojnë në përmbajtjen ose zbatueshmërinë e planit.

(4) Banka është e detyruar që pa vonesë t'a njoftojë Bankën Popullore për ndryshimet që mund të ndikojnë në përmbajtjen ose zbatueshmërinë e planit të paragrafit (3) të këtij neni.

(5) Banka është e detyruar që të sigurojë dhe t'ia dorëzojë Bankës Popullore të gjitha informacionet dhe të dhënat e nevojshme për zhvillimin, përditësimin dhe zbatimin e planit për ndërhyrje të jashtëzakonshme.

(6) Plani për ndërhyrje të jashtëzakonshme, me përjashtim të planit të nenit 6 të këtij ligji, përmban së paku:

- 1) përmbledhje të elementeve kryesore të planit;
- 2) përmbledhje të ndryshimeve të rëndësishme që kanë ndodhur në bankë pas ndryshimit të fundit të planit për ndërhyrje të jashtëzakonshme;
- 3) vlerësim të ekzistimit të interesit publik;
- 4) përshkrim të mënyrës se si funksionet kritike dhe linjat kryesore tregëtare të bankës mund të ndahen nga pjesa tjetër e funksioneve dhe linjave, për të siguruar vazhdimësinë e tyre në rast të plotësimit të kushteve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme mbi bankën sipas nenit 19, paragrafi (1) të këtij ligji;
- 5) vlerësim të kohës së nevojshme për zbatimin e secilës pjesë të rëndësishme të planit;
- 6) përshkrim të vlerësimit të mundësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme, të kryer në përputhje me nenin 8 të këtij ligji;
- 7) përshkrim të masave për heqjen e pengesave të identifikuara për ndërhyrje të jashtëzakonshme, në përputhje me nenin 9 të këtij ligji;
- 8) përshkrim të procesit të përcaktimit të vlerës dhe mundësive për transferimin e funksioneve kritike, linjave kryesore afariste dhe aseteve të bankës;
- 9) përshkrim të mënyrës se si sigurohet marrja e informacioneve dhe të dhënave të përditësuara nga banka dhe disponueshmëria e tyre në çdo kohë;

10) shpjegim të mënyrave të mundshme të financimit të aktiviteteve për ndërhyrjen e jashtëzakonshme mbi bankën, pa përdorim;

2) ndihmë të jashtëzakonshme financiare publike, me përjashtim të mjeteve nga Fondi i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme mbi Bankat,

3) mbështetje të likuiditetit në rrethana të jashtëzakonshme nga Banka Popullore ose

4) mbështetje të likuiditetit nga Banka Popullore me mjete të sigurisë, afatin e maturimit dhe normën e interesit që devijojnë nga ato të zakonshmet;

11) përshkrim të ndërvarësive kritike;

12) përshkrimin e strategjive të ndryshme për ndërhyrje të jashtëzakonshme që mund të zbatohen në varësi prej skenarëve të mundshme dhe afateve për zbatimin e tyre;

13) përshkrim të mënyrave të mundshme për të ruajtur çasjen në sistemet e pagesave dhe sistemet e shlyerjes së obligacioneve, si dhe vlerësimin e transferueshmërisë së pozicioneve të klientëve;

14) analizë të ndikimit të planit të punonjësit e bankës;

15) plan për informimin e mjeteve për informim publik dhe publikut lidhur me ndërhyrjen e jashtëzakonshme mbi bankën;

16) normën minimale të mjeteve të vehta dhe detyrimeve të lejuara në përputhje me nenin 10 të këtij ligji dhe afatin në të cilin banka është e detyruar t'a arrijë atë normë;

17) përshkrim të aktiviteteve dhe sistemeve bazë në bankë që janë të nevojshme për ruajtjen e vazhdimësisë së proceseve operative në bankë;

18) mënyra e bashkëpunimit dhe koordinimit me organet kompetente për ndërhyrjen e jashtëzakonshme dhe/ose mbikëqyrjen jashtë vendit në lidhje me ndërhyrjen e jashtëzakonshme mbi bankën që është filial i bankës së huaj;

19) analiza se si dhe kur banka mund të kërkojë përdorimin e instrumenteve të Bankës Popullore dhe cilat mjete të bankës do të ishin siguri e pranueshme.

(7) Banka Popullore i dorëzondaj bankës përmbledhjen e elementeve kryesore të planit, pas së cilës banka ka të drejtë të paraqesë mendimin e saj në Bankën Popullore, e cila është pjesë përbërëse e planit.

(8) Me kërkesë të Bankës Popullore, banka është e detyruar që listën e kontratave financiare në të cilat është palë kontraktuese t'a përcaktojë dhe t'a përditësojë rregullisht dhe me kërkesë të saj t'ia dorëzojë Bankës Popullore.

(9) Këshilli i Bankës Popullore me akt nënligjor më hollësisht e përcakton përmbajtjen e planit për ndërhyrje të jashtëzakonshme së bankës të planit të përthjeshtuar për ndërhyrje të jashtëzakonshme të nenit 6 të këtij ligji dhe të planit për ndërhyrje të jashtëzakonshmetë grupit bankar të nenit 7 të këtij ligji, si dhe informacionet e nevojshme të paragrafit (5) nga ky nen të këtij ligji dhe afatet dhe mënyrën e dorëzimit të tyre në Bankën Popullore.

Plani i thjeshtësuar për ndërhyrje të jashtëzakonshme

Neni 6

(1) Banka Popullore përpilon plan të thjeshtuar për ndërhyrjen e jashtëzakonshme mbi bankën, për të cilën do të vlerëson se ndërprerja e veprimtarisë dhe zbatimi i procedurës së falimentimit mbi bankën me gjasë nuk do të shkaktojnë pasoja të rëndësishme negative në tregun financiar, bankat e tjera ose në kushtet e financimit.

(2) Banka Popullore gjatë vlerësimit të paragrafit (1) të këtij neni, i merr parasysh kriteret siç janë: madhësinë e bankës, lidhjen me persona të tjerë në sistemin financiar, vëllimin dhe kompleksitetin e aktiviteteve që kryen banka, llojin e aktivitetit, profilin e saj të rrezikut dhe strukturën e aksionerëve dhe të ngjashme.

(3) Plani i thjeshtuar mund të përditësohet me frekuencë më të vogël se sa që është paraparë në nenin 5, paragrafin (3) të këtij ligji.

(4) Nuk mund të hartohet plan i thjeshtësuar i ndërhyrjes së jashtëzakonshme mbi bankat që janë identifikuar si banka me rëndësi sistematike, në përputhje me ligjin që rregullon veprimtarinë e bankave.

(5) Plani i thjeshtësuar i përgatitur për ndërhyrjen e jashtëzakonshme mbi bankën nuk e pengon Bankën Popullore, nëse e sheh të nevojshme, të zbatojë instrumentet dhe autorizimet për ndërhyrje të jashtëzakonshme të parapara me këtë ligj.

(6) Këshilli i Bankës Popullore me akt nënligjor më hollësisht i përcakton kriteret të paragrafit (2) të këtij neni për vlerësimin e ndikimit të ndërprerjes së veprimtarisë së bankës në tregun financiar, bankat tjera dhe kushtet e financimit.

Plani për ndërhyrje të jashtëzakonshme të grupit të bankave

Neni 7

(1) Banka Popullore përgatit plan për ndërhyrje të jashtëzakonshme të grupit të bankave. Në planin për ndërhyrje të jashtëzakonshme të grupit të bankave përcaktohen bartësit e ndërhyrjeve të jashtëzakonshme dhe grupet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

(2) Plani për ndërhyrje të jashtëzakonshme të grupit të bankave veçanërisht parashikon:

1) veprimet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme që mund të ndërmerren ndaj personit amë dhe ndaj anëtarëve të grupit të bankave;

2) nëse grupi i bankave përbëhet nga më shumë grupe për ndërhyrje të jashtëzakonshme, veprimet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme që mund të ndërmerren ndaj zbatësve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme nga secili grup për ndërhyrje të jashtëzakonshme dhe efektet e këtyre veprimeve për anëtarët e tjerë që i përkasin të njëjtit grup të ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe për grupet e tjera të ndërhyrjes së jashtëzakonshme;

3) mënyrën në të cilën instrumentet dhe autorizimet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme mund të zbatohen për bartësit e ndërhyrjeve të jashtëzakonshme në mënyrë të harmonizuar, duke përfshirë masat që do të lehtësonin shitjen e të gjithë grupit të bankave ose do të ndanin funksionet ose linjat afariste të kryera nga anëtarë individualë të grupit të bankave ose grupit për ndërhyrje të jashtëzakonshme, nëse kjo është e nevojshme për ndërhyrje të jashtëzakonshme të grupit të bankave, si dhe përshkrimin e pengesave të mundshme për zbatimin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme;

4) mënyrën e bashkëpunimit dhe e koordinimit me organet kompetente vendase dhe të huaja për mbikëqyrje dhe ndërhyrjes së jashtëzakonshme, në lidhje me ndërhyrjen e jashtëzakonshme të grupit të bankave, kur anëtarët individualë të grupit bankar i nënshtrohen super mbikëqyrjes, përkatësisht ndërhyrje të jashtëzakonshme nga një organ tjetër;

5) mënyrat e mundshme të financimit të aktiviteteve për ndërhyrje të jashtëzakonshme të grupit bankar pa përdorim:

-ndihma të jashtëzakonshme financiare publike, përveç mjeteve nga Fondi i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme mbi Bankën;

-mbështetja e likuiditetit në raste të jashtëzakonshme nga Banka Popullore ose
-ndihma për likuiditet nga Banka Popullore me mjete të sigurisë, afatin e maturimit dhe normën e interesit që devijojnë nga ato të zakonshmet;

6) normën minimale të mjeteve të vehta dhe detyrimeve të lejuara, të përcaktuara në përputhje me nenin 13 të këtij ligji;

7) masat shitesë që mund të marrë Banka Popullore në lidhje me ndërhyrjen e jashtëzakonshme të grupit të bankave.

(3) Plani për ndërhyrje të jashtëzakonshme të grupit të bankave përmban edhe përshkrimin e vlerësimit të mundësisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme të kryer në përputhje me nenin 8 të këtij ligji.

(4) Në lidhje me planin për ndërhyrje të jashtëzakonshme të grupit të bankave, zbatohet neni 5, paragrafi (3), (4), (5), (7), dhe (8) të këtij ligji, ndërsa detyrimet e nenit 5, paragrafët (4) dhe (5) i përmbush subjekti i regjistruar me seli në Republikën e Maqedonisë së Veriut për të gjithë anëtarët e grupit të bankave.

(5) Banka Popullore është e detyruar që informatat e nenit 5, paragrafët (4), (5) dhe (7) të këtij ligji t'ua dorëzojë organeve kompetente për ndërhyrje të jashtëzakonshme ndajfilialeve që janë pjesë e grupit bankar të cilit plani për ndërhyrje të jashtëzakonshme i referohet atyre për të cilët janë të rëndësishme këto dispozita.

Pjesa 2

Mundësia për ndërhyrje të jashtëzakonshme ndaj bankës

Vlerësimi i mundësisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme

Neni 8

(1) Banka Popullore me rastin e përgatitjes dhe përditësimit të planit për ndërhyrjen e jashtëzakonshme mbi bankat përputhje me nenet 5 dhe 6 të këtij ligji vlerëson mundësinë e ndërhyrjes së jashtëzakonshme së bankës.

(2) Mundësia e ndërhyrjes së jashtëzakonshme së një banke ekziston nëse është e mundur dhe e justifikuar të kryhet procedura e falimentimit ndaj bankës ose është e mundshme dhe e justifikuar të zbatohen instrumentet dhe kompetencat e ndërhyrjes së jashtëzakonshme të parashikuar nga ky ligj ndaj bankës, pa shkaktuar ndikim negativ të konsiderueshëm në sistemin financiar dhe sigurimin e çasjes të vazhdueshme në funksionet kritike të bankës. Vlerësimi i aftësisë paguese të bankës nuk mund të bazohet në një supozim për përdorim:

-ndihmë e jashtëzakonshme financiare publike, me përjashtim të mjeteve nga Fondi i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme mbi Bankën;

-mbështetja e likuiditetit në rrethana të jashtëzakonshme ose

-ndihma për likuiditet nga Banka Popullore me mjete sigurie, afat maturimi dhe normë interesi që dallon nga ato të zakonshmet.

(3) Mundësia e ndërhyrjes së jashtëzakonshme të grupit të bankave ekziston nëse është i mundur dhe i justifikuar zbatimi i procedurës së falimentimit ndaj anëtarëve të grupit ose është e mundur dhe e justifikuar të zbatohen instrumentet dhe autorizimet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme për bartësit nga ai grup i bankave pa shkaktuar ndikime të rëndësishme negative në sistemin financiar dhe duke siguruar çasje të vazhdueshme në funksionet kritike të ofruara nga anëtarët e grupit, nëse ato mund të ndahen në kohën e duhur.

(4) Këshilli i Bankës Popullore me akt nënligjor më hollësisht e përcakton mënyrën e vlerësimit të mundësisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme së bankës.

(5) Me rastin e vlerësimit të mundësisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme të grupit të bankave, do të zbatohen paragrafët (1), (2) dhe (4) të këtij neni.

(6) Nëse grupi bankar përbëhet nga disa grupe për ndërhyrje të jashtëzakonshme, vlerësimi i mundësisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme bëhet për secilin grup për ndërhyrje të jashtëzakonshme, në përputhje me përcaktimet në paragrafet (3) dhe (5) të këtij neni.

Heqja e pengesave për ndërhyrje të jashtëzakonshme

Neni 9

(1) Nëse Banka Popullore në bazë të vlerësimit të bërë në përputhje me nenin 8 të këtij ligji konstaton ekzistimin e pengesave të rëndësishme për ndërhyrjen e jashtëzakonshme mbi bankën, Banka Popullore e njofton bankën që të paraqesë propozim me masat dhe afatet për heqjen e pengesave të përcaktuara.

(2) Banka është e detyruar në afat prej katër muajsh nga marrja e njoftimit të paragrafit (1) të këtij neni të paraqesë propozim me masa dhe afate për heqjen e pengesave të përcaktuara.

(3) Me përjashtim të paragrafit (2) të këtij neni, afati për veprimin e bankës është 14 ditë pas marrjes së njoftimit, nëse konstatohen këto pengesa për ndërhyrjen e jashtëzakonshme mbi bankën:

1) banka plotëson normën minimale të mjeteve të veta të nenit 10 të këtij ligji, por nuk plotëson masën totale të shtresave mbrojtëse të kapitalit, të përcaktuara në përputhje me ligjin që rregullon punën e bankave, për efekt të përmbushjes së normës minimale të mjeteve të vehta ose

2) banka nuk plotëson normën minimale të mjeteve dhe detyrimeve të vehta të lejuara, të përcaktuara në përputhje me nenet 10, 11, 12 dhe 13 të këtij ligji.

(4) Nëse Banka Popullore vlerëson se masat dhe afatet e propozuara nga banka në përputhje me paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni janë të përshtatshme, e detyron bankën me vendim që ato masa t'i zbatojë në afatet e përcaktuara.

(5) Nëse Banka Popullore vlerëson se masat e propozuara nga banka në përputhje me paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni nuk mund t'i zvogëlojë ose heq në mënyrë efektive pengesat për ndërhyrje të jashtëzakonshme, ajo me vendim mund ta urdhërojë bankën të marrë masa të tjera për heqjen e pengesave për ndërhyrje të jashtëzakonshme dhe përcaktimin e afateve për veprimin drejt atyre masave.

(6) Në rastet të paragrafit (5) të këtij neni, Banka Popullore mund ta urdhërojë bankën:

1) të rishikojë kontratë për mbështetje financiare nëse një kontratë e tillë ekziston brenda grupit të cilit i përket ose të rishqyrtojë nevojën për të lidhur një kontratë të tillë ose për të lidhur një kontratë për ofrimin e shërbimeve brenda grupit ose me palët e treta, me qëllim sigurimin e ekzekutimit të funksioneve kritike të bankës;

2) të kufizojë ekspozimin ndaj një personi individual dhe/ose ekspozimin total;

3) të tjetërsojë pjesë të aseteve;

4) të kufizojë ose ndalojë kryerjen e aktiviteteve të caktuara ose fillimin e aktiviteteve të reja, zhvillimin e një linje të re afariste ose prezantimin e një produkti të ri;

5) të bëjë ndryshimet e duhura organizative në bankë dhe/ose në çdo anëtar të grupit në të cilin banka është subjekti amë, në mënyrë që të zvogëlohet kompleksiteti i bankës dhe/ose grupit

dhe të jetë në gjendje të ndajë më lehtë funksionet kritike nga funksionet e tjera në procedurën e ndërhyrjes së jashtëzakonshme të bankës;

6) të lëshojë ose të sigurojë detyrime të lejuara në përputhje me huat e neneve 12 ose 13 të këtij ligji;

7) të ndryshojë afatin e maturimit të instrumenteve që janë pjesë e mjeteve vetjake të bankës, pas marrjes së pëlqimit nga Banka Popullore si organ kompetent për super mbikëqyrje dhe/ose detyrimet e lejuara të nenit 11 të këtij ligji;

8) të paraqesë informacion shtesë për qëllimet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme të bankës, në mënyrë të rregullt ose në raste individuale;

9) të ndërmarrë veprime tjera për përmbushjen e normës minimale të mjeteve të vehta dhe detyrimeve të lejuara nga nenet 10 deri në nenin 13 të këtij ligji, duke përfshirë negocimin për ndryshimin e kushteve në të cilat janë lejuar detyrimet, instrumentet e kapitalit bazë shtesë dhe emetohen instrumente të kapitalit shtesë.

(7) Banka është e detyruar t'i dorëzojë Bankës Popullore plan për zbatimin e masave të përcaktuara në vendimin të paragrafit (5) të këtij neni, në afat prej një muaj pas pranimit të vendimit.

(8) Banka Popullore me rastin e marrjes së vendimit nga paragrafët (4) ose (5) të këtij neni vlerëson nëse masat janë proporcionale në raport me pengesat e identifikuar që duhet të zgjidhen dhe merr parasysh ndikimin e mundshëm negativ të pengesave të identifikuar mbi stabilitetin financiar dhe operacionet e bankës, stabilitetin e saj dhe mundësinë për të kontribuar në mbështetjen e ekonomisë.

(9) Për të siguruar kushtet për zbatimin e vendimit të bankës përmes përdorimit të instrumentit për shpërndarje të brendshme të humbjeve të nenit 31 të këtij ligji, Banka Popullore me masën të paragrafit (6), pika 2 e këtij neni, kufizon investimet e bankës në detyrimet për shpërndarjen e brendshme të humbjeve të bankave të tjera, pra kufizon marrjen/emetimin e detyrimeve për shpërndarjen e brendshme të humbjeve të bankave të tjera, me përjashtim të bankave që bëjnë pjesë në të njëjtin grup.

(10) Nëse plani për ndërhyrje të jashtëzakonshme parasheh mundësinë e zbatimit të instrumentit për shpërndarjen e brendshme të humbjeve, Banka Popullore ka të drejtë, nëse e sheh të nevojshme, të vendos në përputhje me këtë nen, t'a udhëzojë bankën që të sigurojë një shumë të aprovuar të kapitalit aksionar ose instrumenteve të tjera nga kapitali bazë i rregullt, në mënyrë që banka të mos kufizohet në emetimin e një sasive të mjaftueshme të aksioneve të reja ose instrumenteve të tjera të pronësisë në mënyrë që të mund të zbatojë shndërrimin e detyrimeve në aksione ose instrumente të tjera pronësie, në rast të zbatimit të autorizimeve të nenit 48, paragrafi (2), pikat 7) deri në 11) të këtij ligji.

(11) Në rastet të paragrafit (10) të këtij neni, Banka Popullore vlerëson nëse kapitali aksionar i miratuar dhe/ose instrumentet tjera nga kapitali bazë i rregullt janë të mjaftueshme për mbulimin e shumës të nenit 36, paragrafi (4), pika 2) dhe 3) të këtij ligji.

(12) Banka Popullore mund ta urdhërojë bankën që të bëjë ndryshime në statut për të hequr çdo pengesë që mund të kufizojë mundësinë e shndërrimit të detyrimeve në aksione ose në instrumente të tjera pronësore.

(13) Nëse konstatohen pengesa domethënëse për ndërhyrjen e jashtëzakonshme mbi bankën në përputhje me paragrafin (1) të këtij neni, Banka Popullore e shtyn krijimin e planit për ndërhyrje të jashtëzakonshme deri në marrjen e vendimit të Bankës Popullore të paragrafit (4) ose paragrafi (5) të këtij neni.

(14) Heqja e pengesave për ndërhyrje të jashtëzakonshme të grupit të bankave do të zbatohen dispozitat e këtij ligji.

Pjesa 3

Mjete vetjake dhe detyrimet e lejuara

Norma minimale e fondeve vetjake dhe detyrime të lejuara

Neni 10

(1) Banka është e detyruar të mbajë vazhdimisht një normë minimale të mjeteve të vehta dhe detyrimeve të lejuara, e cila llogaritet si:

1) marrëdhënie ndërmjet shumës së mjeteve të vehta dhe detyrimeve të lejuara që mund të përfshihen në llogaritjen e normës minimale të mjeteve të vehta dhe detyrimeve të lejuara (në tekstin e mëtejshëm: shuma e mjeteve të vehta dhe detyrimeve të lejuara) dhe aseteve të peshuara sipas rreziqeve; të përcaktuara në përputhje me ligjin që rregullon veprimtarinë e bankave dhe

2) marrëdhënia ndërmjet shumës së mjeteve të vehta dhe detyrimeve të lejuara dhe vlerës së ekspozimit që përfshihet në përcaktimin e normës së huamarrjes, të vendosur në përputhje me ligjin që rregullon veprimtarinë e bankave.

(1) duke pasur parasysh dispozitat e këtij neni dhe nenet 11, 12, 13, 14, 15 dhe 16 të këtij ligji, në të cilat përcaktohet afati deri në të cilin banka është e detyruar të përmbushë shumën e përcaktuar të normës minimale të mjeteve të veta. dhe detyrimet e lejuara.

(2) Në procedurën e hartimit dhe përditësimit të planit për ndërhyrje të jashtëzakonshme, Banka Popullore merr vendim për shumën e normës minimale të mjeteve të vehta individuale dhe të detyrimeve të lejuara për secilën bankë ose grup bankar, duke marrë parasysh dispozitat e këtij neni dhe neneve 11 deri në nenin 16 të këtij ligji, i cili përcakton afatin në të cilin banka është e detyruar të përmbushë shumën e përcaktuar të normës minimale të mjeteve të vehta dhe detyrimeve të lejuara.

(3) Me rastin e sjelljes së vendimit të paragrafit (2) të këtij neni, Banka Popullore i merr parasysh huat shtesë për kapital që banka është e detyruar t'i plotësojë, në bazë të ligjit me të cilin rregullohet puna e bankave.

(4) Banka Popullore e përcjell përmbushjen e normës minimale të mjeteve vetjake dhe detyrimeve të lejuara të paragrafit (2) të këtij neni.

(5) Këshilli i Bankës Popullore me akt nënligjor përcakton mënyrën e normës minimale të mjeteve të vehta dhe detyrimeve të lejuara, duke përfshirë:

1) përcaktimin e detyrimeve të lejuara që mund të përfshihen në llogaritjen e normës minimale të mjeteve të vehta dhe detyrimeve të lejuara, duke marrë parasysh dispozitat e nenit 11 të këtij ligji;

2) llojin e dokumentacionit, kushtet dhe procedurën për dhënien e pëlqimit paraprak të nenit 11, paragrafi (4) të këtij ligji;

3) përmbajtjen dhe shpeshtësimin e raportimit nga Banka Popullore për pozicionet individuale nga totali i mjeteve të vehta dhe detyrimeve të lejuara;

4) përmbajtjen dhe shpeshtësinë e të dhënave dhe informacioneve që bankat duhet të publikojnë në lidhje me normën minimale të mjeteve të vehta dhe detyrimeve të lejuara;

5) mënyrën e përcaktimit të shumës maksimale të lejuar për shpërndarje lidhur me shumën e mjeteve vetjake dhe detyrimeve të lejuara të nenit 14 të këtij ligji, duke përfshirë llojin e

informacionit që banka është e detyruar të dorëzojë, në përputhje me nenin 14, paragrafi (2) të këtij ligji;

6) mënyrën e përcaktimit të normës minimale të mjeteve të vehta dhe detyrimeve të lejuara të një banke që nuk është bartës i ndërhyrjes së jashtëzakonshme, duke përfshirë detyrimet e lejuara që mund të përfshihen në përmbushjen e normës minimale të mjeteve të vehta dhe detyrimeve të lejuara të bankës, e cila nuk është bartëse e vendimit të nenit 13, paragrafi (3) të këtij ligji.

Detyrime të lejuara

Neni 11

(1) Detyrimet e mëposhtme konsiderohen si detyrime të lejuara dhe përfshihen në shumën e mjeteve vetjake dhe detyrimeve të lejuara: 1) instrumentet me maturim të mbetur më shumë se një vit të cilat: - janë përcaktuar me nenin 10, paragrafi (5), pika 1) të këtij ligji,

- nuk përjashtohen në përputhje me paragrafin (2) të këtij neni dhe

- nuk plotësojnë kushtet për përfshirje në kapitalin bazë të rregullt, kapitalin bazë shtesë dhe kapitalin shtesë, në përputhje me ligjin që rregullon veprimtarinë e bankave;

2) instrumente nga kapitali shtesë i bankës me maturim të mbetur deri në një vit, deri në shumën që nuk plotëson kushtet për t'u përfshirë në kapitalin shtesë, në përputhje me ligjin që rregullon veprimtarinë e bankave.

(2) Detyrimet që përjashtohen nga totali i mjeteve të veta të bankës dhe detyrimet e lejuara konsiderohen si në vijim:

1) detyrimet të nenit 32, paragrafi (2) të këtij ligji;

2) depozitat pa afat dhe depozitat afatshkurtra me afat maturimi kontraktues deri në një vit;

3) shuma e depozitave të pranueshme që tejkalon shumën e kompensimit;

4) depozitat që do të konsideroheshin depozita të pranueshme nëse nuk do të pranoheshin në degët e bankës jashtë vendit;

5) detyrimet e shkaktuara në bazë të derivativave financiarë dhe instrumenteve të huamarjes në të cilat janë të përfshira derivativët.

(3) Për qëllimet e paragrafit (2), pika 5) të këtij neni, instrumentet e huamarrjes që përmbajnë opcionin për tërheqje/ndërhyrje të jashtëzakonshme të parakohshme si e drejtë diskrecionale e vetëm emetuesit dhe instrumentet e huamarrjes me norma interesi të ndryshueshme të lidhura me normat e interesit referencë nuk konsiderohen si detyrime të lindura në bazë të derivativëve financiarë.

(4) Banka nuk mund t'i blen ose t'i paguan detyrimet e lejuara që nuk janë mjete vetjake, as të zvogëlojë vlerën e tyre para afatit të maturimit kontraktues, pa marrë pëlqimin paraprak nga Banka Popullore.

(5) Banka mund t'ua shesë detyrimet e lejuara klientëve të vegjël, vetëm nëse bëhet fjalë për detyrime të klientit të vogël me vlerë nominale së paku 50.000 euro në kundërvlerë denari, sipas kursit mesatar të këmbimit të Bankës Popullore në ditën e shitjes së tyre, ndërsa për këtë lloj investitor plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji që rregullon instrumentet financiare.

Përcaktimi i normës minimale të mjeteve vetjake dhe detyrimeve të lejuara

Neni 12

(1) Gjatë përcaktimit të normës minimale të mjeteve të personale dhe detyrimeve të lejuara të nenit 10 të këtij ligji, merren parasysh së paku këto kriterë:

1)nevoja për të mundësuar arritjen e qëllimeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme të bankave duke zbatuar instrumentet e duhura të ndërhyrje të jashtëzakonshme, përfshirë instrumentin për shpërndarjen e brendshme të humbjeve;

2)nevoja për t'i mundësuar bankës dhe filialeve të saj që janë banka, por nuk janë bartës të ndërhyrje të jashtëzakonshmeve, që të kenë një sasi të mjaftueshme të mjeteve të vehta dhe detyrimeve të lejuara për të mbuluar humbjet nëpërmjet instrumentit për shpërndarjen e brendshme të humbjeve ose nëpërmjet fshirjes ose me anë të konvertimit në instrumente kapitale të përshtatshme dhe detyrime të lejuara dhe për arritjen e normës së mjaftueshmërisë së kapitalit ose të normës së huamarrjes në nivelin e nevojshëm për funksionimin normal të bankës, në përputhje me ligjin që rregullon funksionimin e bankave;

3)nevojën për t'i mundësuar bankës të ketë një sasi të mjaftueshme të aseteve dhe detyrimeve të vehta për të mbuluar humbjet dhe për të arritur një shumë të mjaftueshmërisë së kapitalit ose shumën e huamarrjes në një nivel të nevojshëm për funksionimin normal të bankës në përputhje me ligjin që rregullon funksionimin e bankave, nëse plani për ndërhyrje të jashtëzakonshme parashikon që disa lloje detyrimesh të lejuara të përjashtohen nga zbatimi i instrumentit për alokim të brendshëm në përputhje me nenin 33 të këtij ligji ose nëse parashikohet transferimi i tyre tek pala e tretë në rast transferimi të pjesshëm.

4)madhësinë, modelin e biznesit, mënyrën e financimit dhe profilin e rrezikut të bankës;

5)ndikimin negativ që ndërprerja e veprimtarisë së bankës do të kishte në stabilitetin financiar, si rezultat të lidhjes së bankës me banka të tjera ose me institucione të tjera të sistemit financiar;

6)struktura aksionere e bankës dhe lidhja e saj me anëtarët e tjerë të grupit të cilit i përket, posaçërisht nëse banka i përket një grupi jashtë vendit.

(2) Nëse me planin për ndërhyrje të jashtëzakonshme së bankës parashihet zgjidhja ose fshirja ose konvertimi i instrumenteve përkatëse kapitale dhe detyrimeve të lejuara në përputhje me nenin 43 të këtij ligji, shuma e mjeteve dhe detyrimeve të lejuara është e barabartë me shumën që do të mundësojë:

1)mbulimin e plotë të humbjeve që pritet të ndodhin (në tekstin e mëtejshëm: shuma e mbulimit të humbjeve), dhe

2)rritja e fondeve të vehta të bankës dhe filialeve të saj që janë banka, por që nuk janë bartëse të vendimit në një nivel që do të mundësojë funksionimin e qetë të bankës në përputhje me ligjin që rregullon veprimtarinë e bankave (në tekstin e mëtejshëm shuma e rikapitalizimit).

(3) Me përjashtim të paragrafit (2) të këtij neni, nëse plani për ndërhyrje të jashtëzakonshme ndajbankave parasheh zbatimin e falimentimit, Banka Popullore mund të përcaktojë normën minimale të mjeteve të vehta dhe detyrimeve të lejuara vetëm në bazë të shumës të paragrafit (2), pika 1) e këtij neni, duke marrë parasysh ndikimin që do të kishte falimentimin e bankës në institucionet tjera në sistemin financiar dhe në stabilitetin financiar në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

(4) Shuma për rikapitalizim përcaktohet në bazë të të dhënave të disponueshme sipas aktivitetit të ponderuar sipas rreziqeve dhe ekspozimit, të përshtatura për ndryshimet në shumën e tyre që do të ishin shkaktuar si rezultat i aplikimit të instrumenteve për ndërhyrje të jashtëzakonshme të parapara në planin për ndërhyrje të jashtëzakonshme.

(5) Gjatë përcaktimit të shumës për rikapitulim, Banka Popullore e ka parasysh nevojën që banka të mbajë nivelin e duhur të besimit në treg në periudhë prej së paku një viti pas përfundimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme të bankës, të vazhdojë pa pengesa të ushtrojë funksionet kritike dhe të ketë qasje në burimet e financimit, pas zbatimit të strategjisë së përshtatshme të ndërhyrje të jashtëzakonshme, pa pasur nevojë për ndihmë të jashtëzakonshme financiare publike, me përjashtim të përdorimit të të dhënave nga Fondi i ndërhyrjes së jashtëzakonshme, në përputhje me nenin 34, paragrafët (2) dhe (6) dhe neni 74, paragrafi (2) të këtij ligji. Gjatë përcaktimit të shumës së nevojshme për rikapitulim për realizimin e këtij qëllimi fillohet nga shuma e përgjithshme e shtresave të mbrojtura të kapitalit që banka është e detyruar ta mbajë pas aplikimit të instrumenteve për ndërhyrje të jashtëzakonshme, e zvogëluar për shumën nga shtresa mbrojtëse ciklike e kapitalit.

(6) Shuma e mjeteve të vehta dhe e detyrimeve të lejuara për një bankë që është identifikuar si bankë me rëndësi sistematike, në përputhje me ligjin që rregullon veprimtarinë e bankave, është së paku e barabartë me:

- 1) 13.5% e aseteve të peshuara sipas rreziqeve, dhe
- 2) 5% e vlerës së ekspozimit.

(7) Banka Popullore mund të vendosë që minimumi të paragrafit (10) të këtij neni të zbatohet për bankën që nuk është identifikuar si bankë me rëndësi sistematike në përputhje me ligjin me të cilin rregullohet puna e bankave, nëse konsideron se ndërprerja nga operacionet e bankës mund të paraqes rrezik për stabilitetin financiar në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Gjatë vendosjes merren parasysh:

- niveli i depozitave dhe niveli i instrumenteve të huamarrjes, si burime të financimit të bankave,
- çasjen në treg të instrumenteve që konsiderohen si detyrime të lejuara dhe
- shkallën në të cilën banka përdor kapitalin bazë të rregullt për të përmbushur nivelin e kërkuar të normës minimale të mjeteve të vehta dhe detyrimeve të lejuara të nenit 10, paragrafi (2) të këtij ligji.

(8) Shuma e mjeteve vetjake dhe e detyrimeve të lejuara për një bankë që nuk është bartës i vendimit përcaktohet me zbatimin e duhur të paragrafëve (4), (5), (6), (7), (8), (9) dhe (10) të këtij neni. Me rastin e përcaktimit të shumës së rikapitalizimit, merret parasysh shuma që do të nevojitej pas zbatimit të fshirjes ose konvertimit të instrumenteve të duhura kapitale dhe të detyrimeve të lejuara, të kryera në përputhje me nenin 43 të këtij ligji.

Shuma e fondeve vetjake dhe detyrimeve të lejuara në bazë të konsoliduar

Neni 13

(1) Banka që është bartëse e ndërhyrjes së jashtëzakonshme është e detyruar t'i përmbushë huat e nenit 12 të këtij ligji në baza të konsoliduara, në nivel të grupit të ndërhyrje të jashtëzakonshme.

(2) Me rastin e përcaktimit të normës minimale të fondeve të vehta dhe detyrimeve të lejuara për një bankë që është bartëse e ndërhyrjes së jashtëzakonshme në baza të konsoliduara, merret parasysh nëse filialet në vende të tjera do t'i nënshtrohen ndërhyrje të jashtëzakonshme individuale, në përputhje me planin për ndërhyrje të jashtëzakonshme.

(3) Banka e cila është filial i një banke që është bartës i ndërhyrjes së jashtëzakonshme ose i personit që është bartës i ndërhyrjes së jashtëzakonshme nga një vend tjetër, por që nuk është

bartës i ndërhyrjes së jashtëzakonshme, është e detyruar t'i plotësojë huat të nenit 12 të këtij ligji, në bazë individuale.

(4) Me përjashtim të paragrafit (3) të këtij neni, Banka Popullore mund të përjashtojë bankën e cila është filial i bankës që është bartës i ndërhyrjes së jashtëzakonshme nga përmbushja e kushteve të nenit 12 të këtij ligji, në baza individuale. nëse:

1) filiali dhe bartësi i ndërhyrjes së jashtëzakonshme janë me seli në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe janë pjesë e të njëjtit grup për ndërhyrje të jashtëzakonshme;

2) bartësi i ndërhyrjes së jashtëzakonshme i plotëson kushtet të paragrafit (1) të këtij neni;

3) nuk ka dhe nuk pritet që të ketë pengesa të rëndësishme praktike ose ligjore për transferimin e shpejtë të aseteve të vehta ose për ndërhyrje të jashtëzakonshme ndaj detyrimeve të bartësit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme në favor të filialit;

4) bartësi i ndërhyrjes së jashtëzakonshme i plotëson huat e Bankës Popullore si organ kompetent për super mbikëqyrje lidhur me sistemin e drejtimit të filialit dhe ka dhënë deklarata me shkrim me të cilën garanton pagesën e detyrimeve të filialit;

5) proceset e administrimit të rrezikut të kryera nga bartësit e ndërhyrjes së jashtëzakonshme përfshijnë edhe filialin.

E drejta për të kufizuar shpërndarjen e rezultatit nga funksionimi

Neni 14

(1) Banka e cila përshkak të përmbushjes së normës minimale të mjeteve të vehta të nenit 10 të këtij ligji, nuk e plotëson shumën e përgjithshme të shtresave mbrojtëse të kapitalit, është e detyruar të caktojë shumën maksimale të lejuar për shpërndarje lidhur me shumën e fondeve të vehta dhe detyrimeve të lejuara.

(2) Banka të paragrafit (1) të këtij neni është e detyruar që menjëherë t'a njoftojë Bankën Popullore për mospërmbushjen e shumës së përgjithshme të shtresave mbrojtëse të kapitalit dhe për lartësinë e shumës maksimale të lejuar për shpërndarje lidhur me në shumën e akseseve dhe detyrimeve të lejuara të vehta, të përcaktuara në përputhje me këtë nen.

(3) Banka Popullore mund të vendosë të kufizojë shpërndarjen e rezultatit të punës të bankës të paragrafit (1) të këtij neni, vetëm në shumën që nuk e kalon shumën maksimale të lejuar për shpërndarje lidhur me shumën e mjeteve të vehta dhe detyrimeve të lejuara, duke u bazuar në vlerësimin e elementëve në vijim:

- arsyen, kohëzgjatjen dhe nivelin e mospërmbushjes së shumës totale të shtresave mbrojtëse të kapitalit në përputhje me paragrafin (1) të këtij neni, duke përfshirë ndikimin e mospërmbushjes të aftësisë të bankës për të zgjidhur;

- gjendja financiare e bankës dhe mundësia e përmbushjes së kushteve të nenit 19, paragrafi (2) të këtij ligji;

- mundësitë reale të bankës për të arritur sasinë totale të shtresave mbrojtëse të kapitalit brenda një afati të arsyeshëm;

- arsyet për të cilat banka nuk është në gjendje të zëvendësojë detyrimet që nuk plotësohen më kriteret e këtij ligji për detyrimet e lejuara (qoftë ato arsye që lidhen me situatën në bankë ose janë rezultat i lëvizjeve të tregut);

- ndikimi që do të ketë vendimi për kufizimin e shpërndarjes së rezultatit të punës në situatën financiare dhe mundësinë për ndërhyrjen e jashtëzakonshme mbi bankën.

(4) Vlerësimi i elementeve të paragrafit (3) të këtij neni bëhet së paku në baza mujore, gjatë gjithë periudhës derisa banka të plotësoj sasinë e përgjithshme të shtresave mbrojtëse të kapitalit sipas paragrafit 1 të këtij neni.

(5) Nëse banka vazhdon të mos përmbushë shumën e përgjithshme të shtresave mbrojtëse të kapitalit në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni dhe brenda një afati prej nëntë muaj pas dorëzimit të njoftimit të paragrafit (2) të këtij neni, Banka do të marrë vendimin të paragrafit (3) të këtij neni, përveç nëse vlerëson se plotësohen të paktën dy nga kriteret e mëposhtme:

1) Mosplotësimi i masës totale të shtresave mbrojtëse të kapitalit, sipas pikës 1 të këtij neni, është pasojë e çrregullimeve serioze në funksionimin e tregjeve financiare që shkakton tronditje në më shumë segmente të tregjeve financiare;

2) Shkeljet nga pika 1) e këtij paragrafi shkaktojnë lëvizje negative në çmimet e instrumenteve kapitale që janë pjesë e fondeve vetjake dhe të instrumenteve që konsiderohen si detyrime të lejuara të bankës ose rritje të shpenzimeve të saj, si dhe çojnë në ose mbyllje të plotë ose të pjesshme të tregjeve financiare, për këtë arsye banka nuk ka mundësi të emetojë këto instrumente në ato tregje;

3) Mbyllja e tregjeve financiare nga pika 2) e këtij paragrafi ndikon negativisht në bankë, por edhe në disa banka të tjera dhe/ose institucione financiare;

4) Shkeljet nga pika 1) e këtij paragrafi e kufizojnë bankën nga emetimi i instrumenteve kapitale që janë pjesë e fondeve vetjake dhe/ose instrumenteve që konsiderohen si detyrime të lejuara në një masë të mjaftueshme për të kapërcyer mospërmbushjen e masës totale të shtresave mbrojtëse të kapitalin në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni;

5) Sjellja e vendimit të paragrafit (3) të këtij neni mund të shkaktojë efekte negative në pjesën tjetër të bankave, me çka mund të rrezikohet stabiliteti financiar në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

(6) Nëse në bazë të vlerësimit të paragrafit (5) të këtij neni, Banka Popullore vendos që të mos merret vendimi të paragrafit (3) të këtij neni, është e detyruar të kontrolloj përmbushjen e kriterëve të paragrafit (5) të këtij neni në bazë mujore, gjatë gjithë periudhës deri në plotësimin e masës totale të shtresave mbrojtëse të kapitalit nga banka, sipas paragrafit 1 të këtij neni.

(7) Shpërndarja e rezultatit të operimit të paragrafit (3) të këtij neni ka të bëjë me:

- shpërndarjen e rezultatit të punës në lidhje me pozicionet e kapitalit të rregullt bazë;

- marrja e detyrimit për të paguar tarifa të ndryshueshme ose pagesa të tarifave të ndryshueshme nëse banka ka marrë përsipër detyrimin e pagesës në momentin kur nuk ka plotësuar sasinë e kërkuar të shtresave mbrojtëse të kapitalit, të përcaktuar në përputhje me këtë ligj ose

- pagesa në bazë të instrumenteve që janë pjesë e kapitalit bazë shtesë të bankës.

Mosrespektimi i normës minimale të mjeteve të vetjake dhe detyrimeve të lejuara

Neni 15

(1) Banka Popullore është e detyruar të ndërmarrë veprime në rast të mos respektimit të normës minimale të mjeteve të vetjake dhe detyrimeve të lejuara të përcaktuara në përputhje me këtë ligj.

(2) Veprimtaritë të paragrafit (1) të këtij neni i referohen së paku masave që mund të ndërmerren në përputhje me nenin 9 të këtij ligji për heqjen e pengesave për ndërhyrje të jashtëzakonshme, kufizimin e shpërndarjes së rezultatit të veprimit të nenit 14 të këtij ligji,

sanksionet kundërvajtëse që mund të shqiptohen në përputhje me këtë ligj si dhe masat që mund të ndërmerren në përputhje me ligjin që rregullon funksionimin e bankave.

(3) Në rastet nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, Banka Popullore, si organ kompetent për super mbikëqyrje, mund të iniciojë procedurë për vlerësimin e përmbushjes së kushteve të nenit 19, paragrafi (2) nga ky ligj.

Përfshirjet e lejuara

Neni 16

(1) Huat për nivelet e shumës së mjeteve vetjake dhe detyrimeve të lejuara të nenit 12, paragrafët (10) dhe (11) të këtij ligji nuk do të zbatohet për periudhën dyvjeçare pas datës:

1)për marrjen e vendimit për zbatimin e instrumentit për shpërndarjen e brendshme të humbjes;

2)për të cilat banka ka zbatuar masa në përputhje me nenin 19, paragrafi (1), pika 2) të këtij ligji, me të cilat është kryer fshirja ose shndërrimi i instrumenteve kapitale ose detyrimeve të tjera në instrumente nga kapitali bazë i rregullt;

3)mbi të cilin është kryer fshirja ose konvertimi i instrumenteve përkatëse kapitale dhe detyrimeve të lejuara, në përputhje me nenin 43 të këtij ligji, nëse fshirja ose konvertimi është kryer për rikapitalizimin e bankës, pa aplikuar instrumentet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

(2) Huat për nivelet e shumës së mjeteve të vehta dhe detyrimeve të lejuara të nenit 12, paragrafët (10) dhe (11) nga ky ligj nuk do të zbatohet në afat prej tre vjetësh pasi banka i ka plotësuar kushtet për zbatimin e dispozitave të nenit 12, paragrafët (10) dhe (11) të këtij ligji.

(3) Banka Popullore nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni do t'i dorëzojë bankës plan me dinamikë vjetore për arritjen e nivelit të kërkuar të normës minimale të mjeteve të veta dhe detyrimeve të lejuara, të cilat banka është e detyruar t'i respektoj.

(4) Banka Popullore mund ta rishikojë planin të paragrafit (3) të këtij neni dhe të kërkojë dinamikë të ndryshme për arritjen e nivelit të kërkuar të normës minimale të mjeteve të vehta dhe detyrimeve të lejuara, të cilat banka është e detyruar t'i respektoj.

KAPITULLI III NDËRHYRJA E JASHTËZAKONSHME MBI BANKËN

Pjesa 1

Fillimi i procedurës së ndërhyrjes së jashtëzakonshme mbi bankën

Qëllimet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme

Neni 17

(1) Ndërhyrja e jashtëzakonshme bëhet për arritjen e qëllimeve të mëposhtme:

1)sigurimin e vazhdimësisë në kryerjen e funksioneve kritike të bankës;

2)shmangia e ndikimit të rëndësishëm negativ në stabilitetin e sistemit financiar;

3)mbrojtja e fondeve publike duke minimizuar mundësinë e përdorimit të ndihmës së jashtëzakonshme financiare publike;

4)mbrojtja e depozituesve që kanë mbuluar depozita;

5)mbrojtja e parave të gatshme dhe e pasurive të tjera të klientëve të bankës.

(2) Qëllimet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme kanë rëndësi të njëjtë dhe me rastin e zbatimit të instrumenteve dhe autorizimeve për ndërhyrje të jashtëzakonshme, Banka Popullore reciprokisht i harmonizon qëllimet e vendimit sipas rrethanave të secilit rast individual.

(3) Banka Popullore me rastin e arritjes së qëllimeve të ndërhyrje të jashtëzakonshme përpiket t'i zvogëlojë shpenzimet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe të parandalojë zvogëlimin e vlerës së bankës, përveç kur kjo është e nevojshme për arritjen e qëllimeve të ndërhyrje të jashtëzakonshme.

Parimet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme

Neni 18

(1) Procedura e ndërhyrjes së jashtëzakonshme të bankës zbatohet në bazë të parimeve të mëposhtme:

- 1) aksionarët e bankës janë të parët që mbulojnë humbjet;
- 2) kreditorët e bankës i mbulojnë humbjet pas aksionarëve, në mënyrë të kundërt nga rradha e ndërhyrjes së jashtëzakonshme të huave në procedurën e falimentimit të bankës, përveç nëse me këtë ligj është përcaktuar ndryshe;
- 3) depozitat e mbuluara janë plotësisht të mbrojtura;
- 4) shkarkohen anëtarët e këshillit mbikëqyrës, anëtarët e këshillit drejtues dhe/ose personat me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta të bankës, përveç nëse Banka Popullore konsideron se mbajtja e anëtarëve ekzistues të këshillit mbikëqyrës dhe/ose drejtues dhe/ose personat me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta janë të nevojshme për qëllime të arritjes së qëllimeve të ndërhyrje të jashtëzakonshme;
- 5) anëtarët e këshillit mbikëqyrës dhe drejtues dhe personat me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta të bankës mbi të cilën ndërhyhet në mënyrë të jashtëzakonshme janë të detyruar të ofrojnë të gjithë ndihmën e nevojshme për arritjen e qëllimeve të ndërhyrje të jashtëzakonshme;
- 6) personat fizikë dhe juridikë që kanë kontribuar në gjendjen në bankë dhe pamundësinë e vazhdimit të punës së saj, i nënshtrohen përgjegjësisë penale dhe/ose përgjegjësisë për dëmin, në përputhje me ligjin;
- 7) kreditorët nga e njëjta urdhërpagesë kanë të njëjtin trajtim, përveç nëse me këtë ligj është përcaktuar ndryshe;
- 8) asnjë kreditor nuk do të ketë humbje më të mëdha se ato që do të kishte nëse ndaj bankës do të hapej procedura e falimentimit, në përputhje me masat mbrojtëse nga nenet 60, 61 dhe 62 të këtij ligji;
- 9) gjatë zbatimit të ndërhyrje të jashtëzakonshme aplikohen masat siguruese të Kapitullit VII të këtij ligji.

(2) Nëse banka është pjesë e një grupi të bankave, gjatë zbatimit të vendimit, Banka Popullore përpiket që të mos shkaktojë ndikim të konsiderueshëm negativ në anëtarët e tjerë të grupit dhe në stabilitetin e sistemit financiar në Republikën e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(3) Kur në bankën mbi të cilën bëhet ndërhyrja e jashtëzakonshme zbatohen instrumentet e shitjes së veprimtarisë, institucioni kalimtar ose ndarja e një pjese të aseteve, dispozitat e ligjit që rregullojnë marrëdhëniet e punës në lidhje me të drejtat e të punësuarve nuk zbatohen në rast transferimi të një shoqërie tregtare ose pjesë të një shoqërie tregtare.

(4) Me rastin e zbatimit të instrumenteve dhe autorizimeve për ndërhyrje të jashtëzakonshme, në përputhje me këtë ligj, zbaton dispozitata që rregullojnë përdorimin e ndihmës shtetërore.

Kushtet për fillimin e procedurës së ndërhyrjes së jashtëzakonshme mbi bankën

Neni 19

(1) Banka Popullore fillon procedurë për ndërhyrjen e jashtëzakonshme mbi bankën nëse konstaton se janë plotësuar këto kushte:

1) gjendja në bankë është e tillë që nuk mundet ose ka gjasa që të mos vazhdojë të punojë, në përputhje me paragrafin (2) të këtij neni;

2) nuk është reale të pritet që ndonjë masë tjetër të merret nga banka ose një person tjetër nga sektori privat, masa të marra në përputhje me ligjin që rregullon funksionimin e bankave ose fshirje ose konvertim të instrumenteve përkatëse të kapitalit dhe detyrimeve të lejuara në përputhje me këtë ligj, në një periudhë të arsyeshme kohore mund të parandalojë ndërprerjen e veprimtarisë së bankës dhe

3) vendimi i bankës është me interes publik, në përputhje me paragrafin (4) të këtij neni.

(2) Për qëllimet e paragrafit (1), pika 1) të këtij neni, konsiderohet se gjendja në bankë është e tillë që ajo nuk mund ose ka gjasa të mos jetë në gjendje të vazhdojë punën nëse së paku një nga kushtet e mëposhtme është plotësuar:

1) ka bazë për heqjen e licencës për themelimin dhe funksionimin e bankës në përputhje me ligjin që rregullon veprimtarinë e bankave, ose ka rrethana objektive që tregojnë se së shpejti do të ketë arsye për heqjen e licencës për themelimin dhe funksionimin e bankës, duke përfshirë, por jo ekskluzivisht dhe për shkak të faktit se banka ka bërë ose ka të gjasa të bëjë humbje që do të zvogëlojnë fondet e vehta plotësisht ose në një shumë të konsiderueshme;

2) mjetet e bankës janë më të vogla se detyrimet e saj ose ka rrethana objektive që tregojnë se së shpejti mjetet do të jenë më të vogla se detyrimet;

3) banka nuk mundet ose ka rrethana objektive që tregojnë se së shpejti nuk do të jetë në gjendje të paguajë detyrimet e marra ose

4) nevojitet ndihmë e jashtëzakonshme financiare publike, me përjashtim të rasteve kur për heqjen e trazirave të rënda në ekonomi dhe ruajtjen e stabilitetit financiar, ndihma e jashtëzakonshme financiare publike jepet në formën e:

-garancisë shtetërore për mbështetjen e likuiditetit të ofruar nga Banka Popullore, në përputhje me kushtet e përcaktuara prej saj;

-garancinë shtetërore për detyrimet e sapoemetuara të bankës ose

-rikapitalizimin ose blerjen e instrumenteve kapitale, me një çmim dhe në kushte që nuk i japin bankës përparësi në treg, nëse në momentin e miratimit të ndihmës financiare nuk plotësohen kushtet nga pikat 1), 2) dhe 3) nga ky paragraf e as kushtet të nenit 43, paragrafi (6) të këtij ligji. Kjo ndihmë ofrohet deri në shumën e nevojshme për të kompensuar mungesën e fondeve të vehta të përcaktuara nga stres testet, vlerësimet e cilësisë së mjeteve apo vlerësime të ngjashme të nivelit të fondeve të vehta.

(3) Ndihma e jashtëzakonshme financiare publike të paragrafit (2), pika 4), paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni i jepet bankës tretëse në përputhje me rregulloret që rregullojnë përdorimin e ndihmës shtetërore. Ndihma është e një natyre të përkohshme, në përpjesëtim me eliminimin e pasojave të përçarjeve të rënda në ekonomi dhe nuk përdoret për të mbuluar humbjet që banka ka pësuar ose ka gjasa të pësojë së shpejti.

(4) Për qëllimet e paragrafit (1) pikës 3) të këtij neni, ndërhyrja e jashtëzakonshme është me interes publik nëse është një bankë që është identifikuar si bankë me rëndësi sistemike ose nëse

procedura për ndërhyrjen e jashtëzakonshme mbi bankën, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, është e nevojshme për të arritur një ose më shumë nga qëllimet e vendimit të nenit 17 të këtij ligji, të cilat nuk kanë mundur të arrihen në të njëjtën masë nëpërmjet procedurave të falimentimit ose likuidimit të bankës.

(5) Banka Popullore konstaton ekzistimin e interesit publik gjatë hartimit të planit për ndërhyrje të jashtëzakonshme dhe me plotësimin e kushteve të paragrafit (2) nga ky nen. Me plotësimin e kushteve të paragrafit (2) të këtij neni, Banka Popullore mund t'a ndryshojë konkluzionin lidhur me interesin publik të përcaktuar në planin për ndërhyrje të jashtëzakonshme dhe nuk është e detyruar të rishikojë planin për ndërhyrje të jashtëzakonshme të bankës, respektivisht të grupit bankar.

(6) Marrja e masave për ndërhyrje të hershme në përputhje me ligjin që rregullon punën e bankave nuk është kusht për fillimin e procedurës për ndërhyrjen e jashtëzakonshme mbi bankën, në përputhje me këtë ligj.

(7) Anëtarët e këshillit drejtues të bankës janë të detyruar që menjëherë t'a njoftojnë Bankën Popullore nëse konsiderojnë se gjendja në bankë është e tillë që ajo nuk mund të vazhdojë të punojë në kuptim të paragrafit (2) të këtij neni

(8) Për bankën për të cilën Banka Popullore ka konstatuar se janë plotësuar kushtet të paragrafit (1), pikat 1) dhe 2) nga ky nen, por që zgjidhja nuk është në interes publik në përputhje me paragrafin (1), pika 3) e këtij neni, Banka Popullore, si organ kompetent për super mbikëqyrje, merr vendim për revokimin e licencës për themelimin dhe funksionimin e bankës dhe për të përcaktuar plotësimin e kushteve për hapjen e procedurës së falimentimit, në përputhje me ligjin që rregullon funksionimin e bankave.

(9) Për rastet kur konstatohet se janë plotësuar kushtet të paragrafit (1), pika 1) dhe 2) të këtij neni, Banka Popullore, si organ kompetent për super mbikëqyrje ose si organ kompetent për ndërhyrje të jashtëzakonshme, është e detyruar që të njofton:

- Fondin e sigurimit të depozitave, Ministrinë e Financave dhe Komisionin e stabilitetit financiar;
- organi kompetent për super mbikëqyrje dhe organi kompetent për ndërhyrje të jashtëzakonshme ndajshoqërisë amë të bankës në lidhje me të cilën është përcaktuar plotësimi i kushteve të paragrafit (1), pikat 1) dhe 2) nga ky nen;

- organi kompetent për ndërhyrje të jashtëzakonshme ndajsecilit anëtar të grupit bankar në lidhje me të cilin është përcaktuar plotësimi i kushteve të paragrafit (1), pikat 1) dhe 2) të këtij neni;

- organi kompetent për mbikëqyrje dhe organi kompetent për ndërhyrje të jashtëzakonshme ndajpersonit të nenit 2, paragrafi (1), pika 2) dhe 3) të këtij ligji në lidhje me të cilin plotësohen kushtet të paragrafit (1), pikat 1) dhe 2) të këtij ligji.

Kushtet për ndërhyrje të jashtëzakonshme ndaj institucionit financiar dhe holding shoqërie

Neni 20

(1) Banka Popullore mund të ndërmarrë veprime për ndërhyrje të jashtëzakonshme ndajinstitucionit financiar të nenit 2, paragrafi (1), pika 2) të këtij ligji nëse janë plotësuar kushtet të nenit 19, paragrafi (1) të këtij ligji si në lidhje me institucionin financiar ashtu edhe në raport me shoqërin amë të institucionit financiar mbi të cilin Banka Popullore kryen mbikëqyrje në bazë të konsoliduar.

(2) Banka Popullore ndërmerr veprime për ndërhyrje të jashtëzakonshme ndajshoqërisë aksionare të nenit 2, paragrafi (1), pika 3) të këtij ligji nëse janë plotësuar kushtet të nenit 19, paragrafi (1) të këtij ligji në lidhje me holding shoqërin.

Vlerësimi i vlerës për qëllimet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme

Neni 21

(1) Para fillimit të procedurës së ndërhyrje të jashtëzakonshme ose para kryerjes së fshirjes ose konvertimit të instrumenteve përkatëse kapitale dhe detyrimeve të lejuara, Banka Popullore siguron që vlerësimi objektiv dhe real i vlerës së mjeteve dhe detyrimeve të bankës të bëhet nga një shoqëri auditimi, një auditor të autorizuar ose një vlerësues që plotëson kushtet për pavarësi në raport me bankën, në lidhje me çdo organ apo autoritet shtetëror dhe në raport me Bankën Popullore (në tekstin e mëtejshëm: vlerësues i pavarur). Vlerësimi përfundimtar që plotëson të gjitha huat e këtij neni të këtij ligji konsiderohet vlerësim përfundimtar.

(2) Nëse nuk është e mundur të bëhet vlerësim i pavarur i vlerës sipas paragrafit (1) të këtij neni, Banka Popullore në mënyrë të pavarur mund të bëjë vlerësim të përkohshëm të vlerës së pasurisë dhe detyrimeve të bankës në përputhje me paragrafin (11) të këtij neni.

(3) Qëllimi i vlerësimit është vlerësimi i vlerës së mjeteve dhe detyrimeve të bankës në lidhje me të cilat janë plotësuar kushtet të nenit 19, paragrafi (1) nga ky ligj.

(4) Vlerësimi të paragrafit (1) të këtij neni bëhet me qëllim të marrjes së informacionit për:

1)përcaktimin nëse janë përmbushur kushtet për ndërhyrje të jashtëzakonshme ose kushtet për fshirje dhe konvertim të instrumenteve përkatëse kapitale dhe detyrimeve të lejuara;

2)efektet financiare të ndërmarrjes së veprimeve të ndryshme të ndërhyrje të jashtëzakonshme ndaj bankës, nëse plotësohen kushtet për ndërhyrje të jashtëzakonshme ;

3)të marrë vendim për shumën për të cilën duhet të tërhiqet ose zvogëlohet vlera e aksioneve ose instrumenteve të tjera të pronësisë dhe për shumën për të cilën instrumentet përkatëse kapitale dhe detyrimet e lejuara duhet të hiqen ose të shndërrohen në instrumente të bazës së rregullt të kapitalit, nëse zbatohet autorizimi për fshirjen ose konvertimin e instrumenteve përkatëse të kapitalit dhe detyrimeve të lejuara;

4)të sjell vendim për shumën për të cilën duhet të bëhet fshirja ose konvertimi i detyrimeve për shpërndarjen e brendshme të humbjeve, nëse përdoret instrumenti i shpërndarjes së brendshme të humbjeve;

5)të sjell vendim për pasuritë, të drejtat, detyrimet, aksionet ose instrumentet e tjera të pronësisë që duhet të transferohen dhe për shumën e kompensimit që duhet t'i paguhet bankës ose aksionarëve, nëse zbatohen instrumentet: institucioni kalimtar ose ndarja e mjeteve;

6)të sjell vendim për pasuritë, të drejtat, detyrimet, aksionet ose instrumentet e tjera të pronësisë që duhen transferuar dhe marrjen e informacionit për kushtet e tregut, nëse përdoret instrumenti i shitjes së veprimtarisë.

(5) Vlerësimi duhet të siguroj që të gjitha humbjet e bankës njihen plotësisht në kohën kur zbatohen instrumentet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme të bankës ose autorizimi për të fshirë ose konvertuar instrumentet përkatëse të kapitalit dhe detyrimet e lejuara.

(6) Vlerësimi bazohet në supozime konservatore, veçanërisht për shumën e humbjeve. Vlerësimi nuk duhet të bazohet në supozimin e pranimit të ndihmës së jashtëzakonshme financiare publike, mbështetjes së likuiditetit në rrethana të jashtëzakonshme nga Banka

Popullore ose ndihmës likuiditeti nga Banka Popullore me mjete kolaterale, afatin e maturimit dhe normën e interesit që devijojnë nga ato të zakonshmet.

(7) Me rastin e kryerjes së vlerësimit, merret parasysh e drejta e Bankës Popullore dhe e Fondit për ndërhyrje të jashtëzakonshme të bankës për kompensimin e shpenzimeve për ndërhyrje të jashtëzakonshme nga banka ndaj të cilës bëhet ndërhyrje e jashtëzakonshme, në përputhje me nenin 24, paragrafi (5) të këtij ligji, si dhe e drejta e llogaritjes së interesit dhe tarifave për kreditë ose garancitë e dhëna bankës mbi të cilën ndërhyhet në mënyrë të jashtëzakonshme nga mjetet e Fondit të ndërhyrje të jashtëzakonshme të bankës, në përputhje me nenin 74 të këtij ligji.

(8) Raporti i vlerësimit të paragrafit (1) të këtij neni përmban të dhëna nga dokumentacioni afarist dhe dokumentacioni kontabilist i bankës, përkatësisht:

1)bilanci i përditësuar dhe pasqyra e të ardhurave të bankës;

2)analiza dhe vlerësimi i vlerës kontabiliste të mjeteve të bankës;

3)lista e detyrimeve bilancore dhe jashtëbilancore të paraqitura në regjistrat kontabiliste të bankës, duke treguar rendin e pagesës në të cilën ato detyrime do të shpërndareshin në përputhje me ligjin që rregullon punën e bankave;

4)informacione të tjera të rëndësishme për vlerësimin.

(9) Për sjelljen e vendimit të paragrafit (4), pika 5) ose 6) të këtij neni, Banka Popullore mund të kërkojë nga vlerësuesi i pavarur që të dhënat të paragrafit (8), pika 2) të këtij neni t'i plotësojë me analizë dhe përcaktimin e vlerës së tregut të aseteve dhe detyrimeve të bankës.

(10) Vlerësimi përfshin edhe renditjen e kreditorëve në urdhërpagesat në përputhje me ligjin që rregullon veprimtarinë e bankave dhe vlerësimin se sa do të mund të merrnin kreditorët nga çdo urdhërpagesë nëse ndaj bankës hapet procedura e falimentimit. Ky vlerësim nuk cenon zbatimin e parimit sipas të cilit asnjë kreditor nuk do të vihet në pozitë më pak të favorshme se ajo në të cilën do të ishte nëse ndaj bankës do të hapej procedura e falimentimit në përputhje me nenin 61 të këtij ligji.

(11) Nëse për shkak të urgjencës nuk është e mundur të bëhet vlerësimi që do të përfshijë edhe të dhënat nga paragrafët (8) dhe (10) të këtij neni ose kur zbatohet paragrafi (2) të këtij neni, kryet një vlerësim i përkohshëm i vlerës së pasurive dhe detyrimeve të bankës. Vlerësimi i përkohshëm bëhet në përputhje me paragrafin (3) të këtij neni dhe për aq sa është i zbatueshëm në përputhje me paragrafët (1), (8) dhe (10) të këtij neni. Vlerësimi i përkohshëm gjithashtu parashikon shumën e humbjeve shtesë me arsyetimin e duhur.

(12) Nëse bëhet një vlerësim i përkohshëm i vlerës së aseteve dhe detyrimeve të bankës, ai përdoret derisa vlerësuesi i pavarur të kryejë një vlerësim përfundimtar shtesë që plotëson plotësisht të gjitha huat e këtij neni. Banka Popullore siguron që vlerësimi përfundimtar plotësues të bëhet sapo të krijohen kushtet për të dhe mund të bëhet nga i njëjti person që bën vlerësimin të nenit 61 të këtij ligji dhe njëkohësisht me atë vlerësim, por të dy vlerësimet duhet të ndahen. Me përjashtim, në përputhje me paragrafin (14) të këtij neni, Banka Popullore nuk është e detyruar të japë vlerësim përfundimtar plotësues në rastet kur është zbatuar vetëm instrumenti për shitjen e veprimtarisë në përputhje me nenin 25 të këtij ligji.

(13) Qëllimi i vlerësimit përfundimtar shtesë të vlerës është:

1)të gjitha humbjet për të cilat është e nevojshme të zvogëlohen mjetet e bankës të njihen plotësisht në regjistrat kontabilist të bankës dhe

2)të sigurojë të dhëna për marrjen e vendimit për rritjen e vlerës së huave të kreditorëve ose për rritjen e kompensimit në përputhje me paragrafin (14) të këtij neni.

(14) Nëse vlera neto e pasurisë së bankës e përcaktuar me vlerësimin plotësues përfundimtar është më e madhe se vlera neto e pasurisë e përcaktuar me vlerësimin e përkohshëm, Banka Popullore mund të marrë vendim me të cilin:

1) rrit vlerën e huave të kreditorëve ose pronarëve të instrumenteve përkatëse kapitale që janë zgjidhur gjatë aplikimit të instrumentit për shpërndarjen e brendshme të humbjeve, ose

2) urdhëron institucionin kalimtar ose shoqërinë e administrimit të aktiveve t'i paguajë bankës shlyerëse kompensim shtesë për aktivet, të drejtat dhe detyrimet e transferuara ose t'u paguajë aksionarëve kompensim shtesë për aksionet ose instrumentet e tjera të pronësisë, sipas rastit.

(15) Banka Popullore, në bazë të vlerësimit të përkohshëm të paragrafit (11) të këtij neni, mund të ndërmarrë veprime për ndërhyrjen e jashtëzakonshme mbi bankën ose të bëjë fshirjen ose konvertimin e instrumenteve përkatëse kapitale dhe të detyrimeve të lejuara, në përputhje me nenin 43, paragrafi (1) të këtij ligji, duke përfshirë marrjen e kontrollit mbi bankën që është në ndërhyrje të jashtëzakonshme, në përputhje me nenin 59 të këtij ligji.

(16) Vlerësimi është pjesë përbërëse e vendimit për fillimin e procedurës për ndërhyrjen e jashtëzakonshme mbi bankën, për zbatimin e instrumenteve ose autorizimeve për ndërhyrje të jashtëzakonshme ose për zbatimin e fshirjes ose konvertimit të instrumenteve përkatëse të kapitalit dhe detyrimeve të lejuara.

(17) Vlerësimi mund të kontestohet vetëm në kuadër të padisë kundër vendimit të paragrafit (16) të këtij neni.

(18) Këshilli i Bankës Popullore me akt nënligjor më hollësisht përcakton metodologjinë për mënyrën e kryerjes së vlerësimit të vlerës për qëllime të ndërhyrjes së jashtëzakonshme të bankës dhe/ose fshirjes ose konvertimit të instrumenteve përkatëse kapitale dhe detyrimeve të lejuara dhe kushtet për pavarësinë e vlerësuesit të pavarur që mund të kryejë vlerësimin.

Vendim për fillimin e procedurës për ndërhyrjen e jashtëzakonshme mbi bankën

Neni 22

(1) Nëse plotësohen kushtet të nenit 19, paragrafi (1) të këtij ligji, Banka Popullore merr vendim për fillimin e procedurës për ndërhyrjen e jashtëzakonshme mbi bankën, e cila përfshin:

1) arsyet për të cilat ekzistojnë kushte për ndërhyrjen e jashtëzakonshme mbi bankën, duke përfshirë rezultatet e vlerësimit të vlerës;

2) veprimet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme që Banka Popullore ka për qëllim t'i ndërmarrë, duke përfshirë veçanërisht instrumentet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme;

3) ditën dhe orën e saktë të fillimit të procedurës së ndërhyrje të jashtëzakonshme bankare.

(2) Vendimi për fillimin e procedurës së ndërhyrjes së jashtëzakonshme mbi bankën i dorëzohet bankës, Fondit të sigurimit të depozitave, Fondit për ndërhyrjen e jashtëzakonshme mbi bankën, Komisionit të stabilitetit financiar, organit kompetent për super mbikëqyrje dhe organit kompetent për ndërhyrje të jashtëzakonshme të nenit 19, paragrafi (9) alinejat 2, 3 dhe 4 të këtij ligji, operatorit të sistemit të pagesave ose sistemit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme të obligacioneve në të cilin banka në fjalë ka pasur çasje, nëse është e arsyshme edhe Ministrisë së Financave, të njejtën ditë që është sjell vendimi. Banka Popullore pa vonesë i'a dorëzon vendimin për fillimin e procedurës për ndërhyrjen e jashtëzakonshme mbi bankën për regjistrim në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në Depozitën qendrore të obligacioneve dhe në organet tjera kompetente në vend dhe jashtë vendit, nëse është e

arsyeshme, ato janë të detyruar të veprojnë në përputhje me vendimin, që nga momenti i dorëzimit të tij.

(3) Dispozitat të paragrafit (2) të këtij neni i referohen edhe të gjitha vendimeve të mëtutjeshme të Bankës Popullore me të cilat ndërmerren veprime për ndërhyrjen e jashtëzakonshme mbi bankën së caktuar.

(4) Në ditën e marrjes së vendimit të paragrafit (1) të këtij neni, të gjitha masat e ndërmarra nga Banka Popullore si organ kompetent për super mbikëqyrjen e bankës janë në ndërhyrje të jashtëzakonshme, në përputhje me ligjin me të cilin rregullohet puna e bankave pushojnë të vlejné, si dhe të gjitha kompetencat e këshillit drejtues dhe mbikëqyrës dhe të asamblesë të bankës që është në ndërhyrje të jashtëzakonshme, përveç nëse nuk prashihet ndryshe në përputhje me nenin 18, paragrafi (1) të këtij ligji.

(5) Kompetencat e asamblesë të bankës dhe kompetencat e këshillit mbikëqyrës, nëse i pushojnë kompetencat në përputhje me paragrafin (4) të këtij neni, Banka Popullore i kryen me vendime të Bordit drejtues.

(6) Anëtarët e këshillit drejtues të bankës mbi të cilën ndërhyhet në mënyrë të jashtëzakonshme nuk kanë të drejtën e pagesës/ose të një pjese të ndryshueshme të dëmshpërblimit, pavarësisht nëse kjo e drejtë është rënë dakord me bankën mbi të cilën bëhet ndërhyrja e jashtëzakonshme apo rrjedh nga ndonjë marrëveshje e brendëshme ose procedure të brendëshme dhe dispozitat e kontratës për këtë të drejtë bëhen të pavlefshme.

(7) Banka që është në ndërhyrje të jashtëzakonshme është e detyruar t'i njoftojë të gjithë personat për të cilët zbatohet vendimi të paragrafit (1) të këtij neni dhe të gjitha vendimet e mëtutjeshme me të cilat ndërmerren veprimet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, për pjesën e vendimeve të Bankës Popullore që u referohet atyre personave.

(8) Banka Popullore në internet faqen e saj publikon njoftimin për vendimin e marrë të paragrafit (1) të këtij neni dhe për të gjitha vendimet e mëtutjeshme me të cilat ndërmerren veprimet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, si dhe për pasojat e veprimeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme të bankës, posaçërisht në lidhje me personat fizikë që janë klientë të bankës, kushtet dhe periudha e vonesës ose kufizimit të të drejtave dhe detyrimeve nga kontrata, në përputhje me nenet 55, 56 dhe 57 të këtij ligji.

(9) Banka është e detyruar të publikojë në faqen e saj të internetit njoftimin për vendimin e marrë të paragrafit (1) të këtij neni dhe për të gjitha vendimet e mëtutjeshme me të cilat ndërmerren veprime për ndërhyrje të jashtëzakonshme.

(10) Nëse banka është e listuar në bursë ose është shoqëri me detyrime të veçanta për raportim në përputhje me ligjin, njoftimi të paragrafit (8) të këtij neni i dërgohet edhe Bursës së Maqedonisë për publikim në faqen e internetit të saj.

(11) Nëse banka nuk është e listuar në bursë ose nuk është shoqëri me detyrime të veçanta raportuese në përputhje me ligjin, konsiderohet se me shpalljen të paragrafit (8) të këtij neni, aksionarët e bankës kanë marrë vendimin të paragrafit (1) të këtij neni dhe të gjitha vendimet e mëvonshme për ndërrmarjen e veprimeve për ndërhyrje të jashtëzakonshme.

(12) Kontratat e lidhura nga banka deri në ditën e marrjes së vendimit të paragrafit (1) të këtij neni mbesin në fuqi dhe zbatimi i veprimeve dhe instrumenteve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme të bankës nuk mund të jetë bazë që pala tjetër kontraktuese të ndërpresë, të kërkoj ndryshimin e kontratës së caktuar, as të kërkojë kompensim ose realizim të garancisë së dhënë sipas kontratës, me kusht që detyrimet nga ajo kontratë të përmbushen pa ndërprerje nga banka që është në ndërhyrje të jashtëzakonshme.

(13) Regjistri qendror pa vonesë i regjistron ndryshimet që ndodhin në bazë të vendimeve të Bankës Popullore të marra në procedurën e ndërhyrjes së jashtëzakonshme të bankës në përputhje me këtë ligj.

Administrata speciale

Neni 23

(1) Banka Popullore mund të sjell vendim për vendosjen e administratës së posaçme në bankën në të cilën është filluar procedura e ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe të emërojë një ose më shumë anëtarë të administratës speciale (në tekstin e mëtejshëm: drejtues të veçantë), nëse vlerëson se ndryshimi në menaxhimin e bankës do të kontribuojë në arritjen e qëllimeve të ndërhyrje të jashtëzakonshme.

(2) Banka Popullore mund të sjell vendim të paragrafit (1) të këtij neni në çdo moment gjatë procedurës për ndërhyrjen e jashtëzakonshme mbi bankën.

(3) Personi i emëruar për drejtues i veçantë në përputhje me paragrafin (1) të këtij neni duhet t'i plotësojë kushtet që sipas ligjit me të cilin rregullohet puna e bankave, vlejnë për anëtarin e këshillit drejtues dhe për anëtarin e pavarur të bordit mbikëqyrës të një banke. Dispozitat për dhënien e pëlqimit paraprak për një anëtar të bordit të drejtorëve nuk zbatohen për emërimin e një drejtuesi të posaçëm dhe as drejtuesit e posaçëm nuk duhet të jenë punonjës me kohë të plotë të bankës mbi të cilën ndërhyhet në mënyrë të jashtëzakonshme.

(4) Në ditën e sjelljes së vendimit të paragrafit (1) të këtij neni, kompetencat e këshillit drejtues të bankës i kalojnë administratës së posaçme, e cila këto kompetenca i kryen nën kontrollin e Bankës Popullore.

(5) Drejtuesi i posaçëm emërohet për një periudhë jo më të gjatë se një vit. Përgjatë kësaj periudhe mund të zgjatet, nëse Banka Popullore vlerëson se arsyet për të cilat është vendosur administrata speciale ende ekzistojnë.

(6) Në vendimin të paragrafit (1) të këtij neni, Banka Popullore mund të caktojë një ose më shumë ndihmës të administratës speciale, të cilët nuk janë anëtarë të administratës speciale dhe të cilët nuk janë të punësuar në bankën mbi të cilën bëhet ndërhyrja e jashtëzakonshme. dhe të cilët do të kryejnë punë ndihmëse, sipas udhëzimeve të marra nga administrata speciale. Drejtuesit e posaçëm, nëse është e nevojshme, mund të përdorin shërbimet e palëve të jashtme, pas miratimit paraprak të Bankës Popullore.

(7) Administrata e posaçme është e detyruar t'i ndërmarrë të gjitha masat që janë të nevojshme për realizimin e qëllimeve të ndërhyrje të jashtëzakonshme dhe për realizimin e punëve të parapara me vendimet e Bankës Popullore. Kjo detyrë ka përparësi ndaj të gjitha detyrave të tjera të organeve drejtuese që rrjedhin nga ligji ose nga aktet e brendshme të bankës që zgjidhen. Kryerja e kompetencave të administratës së posaçme.

(8) Administrata e posaçme është e detyruar që pa vonesë ta njoftojë Bankën Popullore për të gjitha rastet që mund të ndikojnë negativisht në arritjen e qëllimeve të ndërhyrje të jashtëzakonshme të nenit 17 të këtij ligji dhe zbatimin e veprimeve për ndërhyrje të jashtëzakonshme të parapara me vendimin për fillimin e procedurës. për ndërhyrje të jashtëzakonshme të nenit 22 të këtij ligji.

(9) Me vendimin e Bankës Popullore të paragrafit (1) të këtij neni, caktohen kompetencat dhe detyrat e administratës speciale dhe kufizimet në lidhje me kompetencat e saj. Vendimi mund të

parashikojë që disa veprime të administratës speciale të kërkojnë miratim paraprak nga Banka Popullore.

Përfshirja i detyrimeve nga instrumenti për shpërndarjen e brendshme të humbjeve nga Banka Popullore

Neni 33

(1) Banka Popullore mund të vendos që për qëllime të instrumentit për shpërndarje të brendshme të humbjeve ta përfshijë plotësisht ose pjesërisht një detyrim të caktuar, nëse:

1) detyrimi nuk mund të zgjidhet ose të shndërrohet në aksion në afat të arsyeshëm, përkundër veprimeve të ndërmara nga Banka Popullore me qëllim të zbatimit në kohë dhe efikas të këtij instrumenti;

2) shkyçja është e nevojshme me qëllim të vazhdimin të kryerjes së funksioneve kritike dhe linjave kryesore të biznesit;

3) përfshirja është e nevojshme për të parandaluar ndikimin negativ në sistemin financiar, veçanërisht në lidhje me depozitat e pranueshme nëse fshirja ose shndërrimi i tyre në aksione mund të shkaktojë një kërcënim për stabilitetin financiar në një mënyrë që do të shkaktojë një përçarje serioze të ekonomisë së brendshme, ose

4) zbatimi i instrumentit për shpërndarjen e brendshme të atyre detyrimeve do të çonte në humbje më të mëdha për kreditorët e tjerë.

(2) Shuma e detyrimeve për shpërndarje të brendshme mund të rritet për shumën e detyrimeve që janë përfshirë në përputhje me paragrafin (1) të këtij neni, nëse kjo rritje është në përputhje me parimin e nenit 18, paragrafi (1), pika 8) të këtij ligji.

(3) Me vendimet të paragrafit (1) të këtij neni, Banka Popullore drejtohet nga:

1) rregulli sipas të cilit aksionarët e bankës mbulojnë së pari humbjet, e më pas kreditorët e tjerë të saj, në mënyrë të kundërt të renditjes së ndërhyrjes së jashtëzakonshme të huave të përcaktuara nga ligji që rregullon veprimtarinë e bankave;

2) kapacitetin që do të kishte banka për të mbuluar humbjet, pas përfshirjes së detyrimeve, në përputhje me paragrafin (1) të këtij neni dhe

3) nevojën për të siguruar fonde të mjaftueshme për të financuar ndërhyrje të jashtëzakonshme të bankës.

(4) Këshilli i Bankës Popullore me akt nënligjor më hollësisht i përcakton rastet kur përfshirja i detyrimit të caktuar është e nevojshme për nevojat e instrumentit për shpërndarje të brendshme të humbjeve, në përputhje me paragrafin (1) të këtij neni.

Përdorimi i mjeteve të Fondit për ndërhyrje të jashtëzakonshme në rast të përfshirjes së pjesshme ose të plotë të detyrimeve të lejuara

Neni 34

(1) Në rastet kur për shkak të përfshirjes së detyrimeve të lejuara sipas nenit 33 të këtij ligji, humbjet e bankës nga detyrimet e shpërndarjes së brendshme nuk mund të mbulohen plotësisht, mjetet e Fondit mund të përdoren për:

1)mbulimin e të gjitha humbjeve, të cilat do të mundësonin që vlera neto e pasurisë së bankës të jetë e barabartë me zero, në përputhje me nenin 35, paragrafi (1), pika 1) e këtij ligji;

2)blerjen e aksioneve ose instrumenteve të tjera kapitale me qëllim të rritjes së mjeteve vetjake të bankës, në përputhje me nenin 35, paragrafi (1), pika 2) të këtij ligji.

(2) Mjetet e fondit për ndërhyrje të jashtëzakonshme mund të përdoren për nevojat e paragrafit (1) të këtij neni, nëse:

1)nëpërmjet fshirjes ose shndërrimit në aksione të detyrimeve për shpërndarje të brendshme, ose në një mënyrë tjetër, mbulimit të humbjeve dhe rikapitalizimit në shumën prej të paktën 8% të bilancit të totalit të detyrimeve të bankës, duke përfshirë mjetet vetjake të bankës, në datën e miratimit të vendimit për të ndërmarrë aktivitete për vlerësimin e bankës, në përputhje me nenin 1, në përputhje me këtë vlerë të përcaktuar nga ligji si dhe

2)mjetet e përdorura të Fondit të ndërhyrje të jashtëzakonshme nuk kalojnë 5% të gjendjes së totalit të detyrimeve të bankës, duke përfshirë edhe mjetet e vetë bankës, në datën e miratimit të vendimit për ndërmarrjen e veprimeve për ndërhyrjen e jashtëzakonshme mbi bankën, në përputhje me përcaktimin e vlerës të nenit 21 të këtij ligji.

(3) Mjetet e Fondit për ndërhyrje të jashtëzakonshme të shfrytëzuara për qëllimet e paragrafit (1) të këtij neni rrjedhin nga:

1)kontributet vjetore, në përputhje me nenin 76 të këtij ligji;

2)kontributet shtesë që janë paguar në Fondin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme në përputhje me nenin 77 të këtij ligji, në afat prej tre vjetësh si dhe

3)mjetet e fituara me kontratë kredie dhe forma të tjera financimi, në përputhje me nenin 78 të këtij ligji, nëse mjetet e fituara nga pikat 1 dhe 2 të këtij paragrafi nuk janë të mjaftueshme.

(4) Në raste të jashtëzakonshme, Banka Popullore mund të shfrytëzojë burime plotësuese të financimit në përputhje me nenin 78 të këtij ligji për qëllime të paragrafit (1) të këtij neni, nëse është arritur kufiri të paragrafit (2), pika 2) të këtij neni dhe të gjitha detyrimet e pasiguruara janë zgjidhur ose shndërruar në aksione, përveç depozitave të pranueshme, të cilat sipas ligjit nuk rregullojnë bankat për funksionimin e mëparshëm të bankës.

(5) Nëse plotësohen kushtet të paragrafit (4) të këtij neni, mjetet nga Fondi për ndërhyrje të jashtëzakonshme të siguruara me kontribute vjetore në përputhje me nenin 76 të këtij ligji mund të shfrytëzohen, nëse ato mjete ende nuk janë shfrytëzuar.

(6) Me përjashtim të paragrafit (2), pika 1) të këtij neni, mjetet nga Fondi për ndërhyrje të jashtëzakonshme mund të përdoren për nevojat e paragrafit (1) të këtij neni, nëse:

1)mbulimi i humbjeve me aksionet dhe detyrimet të paragrafit (2), pika 1) të këtij neni është i barabartë me të paktën 20% të mjeteve të peshuar sipas rreziqeve;

2)Fondi për ndërhyrje të jashtëzakonshme ka mjete në vlerë më të madhe se 3% të shumës së përgjithshme të depozitave të mbuluara të të gjitha bankave në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe

3)sipas vlerësimit të vlerës të nenit 21 të këtij ligji, pasuria e bankës në bazë të konsoliduar është më e vogël se 10 miliardë denarë.

Përcaktimi i shumës për ndarjen e brendshme të humbjeve

Neni 35

(1) Në bazë të vlerësimit të vlerës të nenit 21 të këtij ligji, Banka Popullore përcakton shumën e detyrimeve për shpërndarjen e brendshme të humbjeve, të cilat duhet të mbulohen me instrumentin për shpërndarje të brendshme të humbjeve, si mbledhje nga:

1)shuma që duhet shlyer për të mundësuar që vlera neto e mjeteve të bankës që vendoset të jetë e barabartë me zero, nëse është e zbatueshme;

2)shuma që duhet të konvertohet në aksione ose instrumente të tjera kapitale për të arritur normën e kërkuar të kapitalit bazë të rregullt të bankës që po zgjidhet ose të institucionit kalimtar, nëse ajo është e zbatueshme.

(2) Me rastin e përcaktimit të shumës të paragrafit (1) të këtij neni, Banka Popullore merr parasysh mjetet e Fondit për ndërhyrje të jashtëzakonshme që mund të përdoren për qëllime të nenit 74, paragrafi (2), pika 4) të këtij ligji, shumën e kapitalit të nevojshëm për plotësimin e kushteve të përcaktuara me ligjin që rregullon veprimtarinë e bankave, në një periudhë prej së paku një viti pas përcaktimit të masës së duhur të ndërhyrjes së jashtëzakonshme të bankës për të ruajtur vlerën e duhur të ndërhyrjes së jashtëzakonshme të bankës, si dhe vlerën e kapitalit të duhur për mbajtjen e nivelit të parshtatshëm të besimit të tregut i cili rregullohet ose në institucionin kalimtar.

(3) Në rastet kur planifikohet të përdoret instrumenti për ndarje të mjeteve të nenit 30 të këtij ligji, Banka Popullore e merr parasysh shumën e kapitalit të nevojshëm për funksionimin e shoqërisë për administrimin e mjeteve.

(4) Në rastet kur është bërë fshirja në përputhje me nenet 43 dhe 44 të këtij ligji dhe është zbatuar instrumenti për shpërndarjen e brendshme të humbjeve në përputhje me nenin 31, paragrafi (1) të këtij ligji si dhe është konstatuar se fshirja e kryer në bazë të vlerësimit të përkohshëm të nenit 21, paragrafi (11) të këtij ligji e tejkalon shumën e nevojshme përfundimtare të përcaktuar me vlerësimin të nenit 21, paragrafi (12) nga ky ligj, zbatohen dispozitat e nenit 21, paragrafi (14) të këtij ligji.

Trajtimi i aksionarëve gjatë zbatimit të instrumentit për shpërndarjen e brendshme të humbjeve, shlyerjen ose konvertimin e instrumenteve të përshtatshme të kapitalit

Neni 36

(1) Me rastin e zbatimit të instrumentit për shpërndarjen e brendshme të humbjeve të nenit 31, paragrafi (1) të këtij ligji, fshirjen ose konvertimin e instrumenteve të përshtatshme kapitale të nenit 43 të këtij ligji, Banka Popullore mund të ndërmarrë një ose të dyja veprimet e mëposhtme ndaj aksionarëve të bankës që janë në ndërhyrje të jashtëzakonshme:

1)të kryejë një reduktim të thjeshtuar të kapitalit fillestar ose të tërheqë aksionet ose instrumentet e tjera të pronësisë ose t'ua kalojë kreditorëve huat e të cilëve janë përfshirë në instrumentin për shpërndarje të brendshme;

2)Nëse vlera neto e bankës mbi të cilën ndërhyhet në mënyrë të jashtëzakonshme është pozitive, në përputhje me vlerësimin të nenit 21 të këtij ligji, për të ulur pjesëmarrjen e aksionarëve ekzistues, si rezultat i shndërrimit në aksione ose instrumente të tjera pronësie të:

-instrumenteve përkatëse kapitale të lëshuara nga banka në përputhje me autorizimin të nenit 43, paragrafi (1) të këtij ligji, ose

-detyrimet për shpërndarje të brendshme të lëshuara nga banka të cilat zgjidhen në bazë të autorizimit të nenit 48, paragrafi (2), pika 8) të këtij ligji.

(2) Gjatë veprimtarisë të paragrafit (1), pika 2) të këtij neni, Banka Popullore zbaton kursin e konvertimit i cili do të mundësojë zvogëlim të dukshëm të pjesëmarrjes së aksionarëve ekzistues.

(3) Veprimtaritë të paragrafit (1) të këtij neni mund të zbatohen edhe në lidhje me aksionet dhe instrumentet tjera pronësore të emetuara ose të krijuara në bazë të:

-shndërrimi i instrumenteve të huamarrjes në aksione ose instrumente të tjera pronësie të bankës, në përputhje me kontratën me të cilën është lëshuar ose blerë instrumenti i huamarrjes, dhe në bazë të një ngjarje që i ka paraprirë ose ka ndodhur në të njëjtën kohë me vlerësimin e Bankës Popullore për përmbushjen e kushteve për ndërhyrjen e jashtëzakonshme mbi bankën;

-shndërrimi i instrumenteve përkatëse kapitale në instrumente nga kapitali bazë i rregullt, në përputhje me nenin 44 të këtij ligji.

(4) Me rastin e zgjedhjes së veprimtarisë të paragrafit (1) të këtij neni, Banka Popullore ka parasysh:

1) vlerësimin të nenit 21 të këtij ligji;

2) shumën me të cilën duhet të zvogëlohet vlera e instrumenteve nga kapitali i rregullt bazë ose me të cilën duhet të shlyhen ose konvertohen instrumentet përkatëse kapitale, në përputhje me nenin 44, paragrafi (1) të këtij ligji;

3) shumën e detyrimeve për shpërndarje të brendshme e përcaktuar në përputhje me nenin 35 të këtij ligji.

(5) Nëse zbatimi i instrumentit për shpërndarjen e brendshme të humbjeve ose shndërrimi i instrumenteve përkatëse të kapitalit do të shkaktojë fitimin ose rritjen e pjesëmarrjes së kualifikuar në bankë, Banka Popullore, si organ kompetent për mbikëqyrjen, menjëherë, sipas detyrës zyrtare, do të zbatojë procedurën për dhënien e pëlqimit për marrjen e pjesëmarrjes së kualifikuar, në përputhje me ligjin që rregullon funksionimin e bankave, me qëllim mos të shkaktohet shtyrja e aplikimit të instrumentit për shpërndarjen e brendshme të humbjeve ose konvertimin e instrumenteve kapitale përkatëse ose mos të pengohet arritja e qëllimeve të ndërhyrje të jashtëzakonshme.

(6) Nëse Banka Popullore, si organ kompetent për super mbikëqyrje, nuk e përfundon procedurën për dhënien e pëlqimit të paragrafit (5) të këtij neni deri në datën e zbatimit të instrumentit për shpërndarjen e brendshme të humbjeve ose konvertimin e instrumenteve përkatëse kapitale, do të zbatohen dispozitat e nenit 26, paragrafët (4), (5), (6) dhe (7) të këtij ligji.

(7) Këshilli i Bankës Popullore me akt nënligjor do të caktojë trajtimin e aksionarëve gjatë zbatimit të instrumentit për shpërndarje të brendshme të humbjeve, fshirjeve ose konvertimin e instrumenteve përkatëse kapitale në përputhje me paragrafin (1) të këtij neni, duke marrë parasysh dispozitat të paragrafit (4) të këtij neni.

Radhitja e shlyerjes ose konvertimit

Neni 37

(1) Me rastin e aplikimit të instrumentit për ndarje të brendshme të humbjeve, Banka Popullore do t'i fshijë ose konvertojë detyrimet për ndarje të brendshme të cilat nuk janë të përjashtuara nga fushëveprimi i këtij instrumenti në përputhje me nenin 32, paragrafi (2) dhe nenin 33 të këtij ligji, duke zbatuar rendin vijues të ekzekutimit të fshirjes.

1)Zvogëlohet vlera e instrumenteve nga kapitali i rregullt bazë në përputhje me nenin 44, paragrafi (1), pika 1) të këtij ligji;

2)Nëse zvogëlimi i vlerës nga pika 1) e këtij paragrafi është më e vogël se lartësia e shumave të nenit 36, paragrafi (4), pika 2) dhe 3) të këtij ligji, vlera e instrumenteve nga kapitali bazë shtesë zvogëlohet;

3)Nëse zvogëlimi i vlerës nga pikat 1) dhe 2) të këtij paragrafi është më e vogël se lartësia e shumave të nenit 36, paragrafi (4), pika 2) dhe 3) të këtij ligji, vlera e instrumenteve kapitale shtesë zvogëlohet;

4)Nëse zvogëlimi i vlerës nga pikat 1), 2) dhe 3) e këtij paragrafi është më pak se lartësia e shumave të nenit 36, paragrafi (4), pikat 2) dhe 3) të këtij ligji, zvogëlohet vlera e instrumenteve të cilat nuk janë të përfshira në mjetet vetjake të bankës e cila zgjidhet, sipas rendit të kundërt të radhitjes të shlyerjes së borxheve në procedurat e falimentimit të një banke, në përputhje me ligjin që rregullon veprimtarinë e bankave;

5)Nëse ulja nga pikat 1), 2), 3) dhe 4) të këtij paragrafi është më e vogël se lartësia e shumave të nenit 36, paragrafi (4), pika 2) dhe 3) të këtij ligji, vlera e detyrimeve të mbetura për shpërndarjen e brendshme zvogëlohet, sipas rendit të kundërt të radhitjes të ndërhyrjes së jashtëzakonshme të borxheve në procedurën e falimentimit të një banke, në përputhje me ligjin i cili e rregullon veprimtarinë e bankave.

(2) Banka Popullore mbulimin e shumës të nenit 36, paragrafi (4), pika 2) dhe 3) të këtij ligji do ta shpërndajë në mënyrë të barabartë ndërmjet aksioneve dhe instrumenteve të tjera pronësore dhe detyrimeve për shpërndarjen e brendshme të humbjeve me të njëjtin urdhërpagesë duke ulur vlerën e tyre nominale ose shumën e papaguar, përveç nëse lejohet shpërndarje e ndryshme e mbulimit të humbjes ndërmjet detyrimeve me renditje të njëjtë për pagesë, në përputhje me kushtet të nenit 33 paragrafi (1) të këtij ligji ose nëse detyrimet janë jashtë përfshirjes së instrumentit për shpërndarje të brendshme, në përputhje me nenin 32, paragrafi (2) dhe neni 33 të këtij ligji.

(3) Para kryerjes së fshirjes ose konvertimit të paragrafit (1), pika 5) të këtij neni, Banka Popullore do të bëjë konvertimin ose zvogëlimin e vlerës së instrumenteve të paragrafit (1), pikat 2), 3) dhe 4) të këtij neni të cilat më parë nuk janë konvertuar dhe të cilat përmbajnë dispozita që mundësojnë:

1)Zvogëlimin e vlerës së instrumentit pas ndodhjes së një ngjarje të caktuar që lidhet me gjendjen financiare, aftësinë paguese ose nivelin e mjeteve vetjake të bankës;

2)Shndërrimi i instrumentit në aksione ose instrumente të tjera pronësore pas ndodhjes së një ngjarjeje të caktuar që lidhet me gjendjen financiare, aftësinë paguese ose nivelin e mjeteve vetjake të bankës.

(4) Në rastet kur vlera e instrumenteve të paragrafit (3), pika 1 e këtij neni nuk zvogëlohet plotësisht para aplikimit të instrumentit për shpërndarjen e brendshme të humbjeve, Banka Popullore do ta shlyejë ose konverton pjesën tjetër të vlerës së atyre instrumenteve, në përputhje me paragrafin (1) të këtij neni.

(5) Banka Popullore me rastin e sjelljes së vendimit për zvogëlimin e vlerës së detyrimit, respektivisht shndërrimin e tij në instrumente të kapitalit të rregullt bazë, nuk mund ta bëjë konvertimin e principalit të një kategorie të detyrimeve, nëse detyrimet që i nënshtrohen asaj kategorie nuk janë shndërruar në instrumente të kapitalit të rregullt bazë ose nëse nuk është zvogëluar vlerat e tyre, përveç rasteve kur nuk lejohet sipas neneve 32 dhe 33 të këtij ligji.

Derivatit financiar

Neni 38

(1) Pas marrjes së vendimit për ndërhyrjen e jashtëzakonshme mbi bankën, Banka Popullore ka të drejtë të mbyllë para kohe çdo kontratë për derivativet financiarë dhe ta shlyejë ose t'a shndërrojë në instrumente përkatës kapital detyrimin që rrjedh nga derivativi financiar, i cili nuk është i përjashtuar nga objekti i instrumentit të shpërndarjes së brendshme të humbjeve të nenit 33 të këtij ligji.

(2) Nëse derivati financiar është lëndë e veting-angazhimit, në kuadër të vlerësimit të nenit 21 të këtij ligji, Banka Popullore ose vlerësuesi i pavarur do të përcaktojë neto vlerën e detyrimit, duke pasur parasysh dispozitat dhe kushtet e parapara në neting-angazhimin.

(3) Këshilli i Bankës Popullore me akt nënligjor përcakton mënyrën e përcaktimit të vlerës së detyrimeve që rrjedhin nga derivatet financiare.

Shkalla e shndërrimit

Neni 39

(1) Banka Popullore me rastin e zbatimit të autorizimit për shlyerjen ose shndërrimin e instrumenteve kapitale përkatëse dhe detyrimeve të lejuara në përputhje me nenin 43, paragrafi (1) dhe autorizimin të nenit 48, paragrafi (2), pika 8) të këtij ligji, Banka Popullore mund të aplikojë norma të ndryshme shëndruese për kategori të ndryshme të instrumenteve kapitale dhe detyrimeve, në përputhje me njërin ose të dy parimet të paragrafit (2) dhe (3) të këtij neni.

(2) Kursi i shndërrimit duhet të përfaqësojë një kompensim adekuat për kreditorin në fjalë për humbjet që ai ka pasur si rezultat i shlyerjes ose shndërrimit.

(3) Nëse në përputhje me paragrafin (1) të këtij neni zbatohen normat e ndryshme të shndërrimit, norma e shndërrimit që zbatohet për detyrimet që janë me urdhërpagesë më të lartë në përputhje me ligjin që rregullon punën e bankave, është më e lartë se kursi i shndërrimit që zbatohet për detyrimet nga urdhërpagesat më të ulëta.

(4) Këshilli i Bankës Popullore me akte nënligjore më thellësisht e përcakton mënyrën e përcaktimit të normave të shndërrimit.

Plani i riorganizimit

Neni 40

(1) Më së voni në afat prej një muaji pas aplikimit të instrumentit për shpërndarjen e brendshme të humbjeve në përputhje me nenin 31, paragrafi (1), pika 1) të këtij ligji, këshilli drejtues i bankës që është në ndërhyrje të jashtëzakonshme ose personat e ngarkuar nga Banka Popullore për ushtrimin e kompetencës të nenit 59, paragrafi (1) të këtij ligji, janë të detyruar të

përgatisin plan për riorganizimin e bankës e cila zgjidhet, në përputhje me kriteret e paragrafeve (4) dhe (5) të këtij ligji dhe të njëjtin t'a dorëzojnë në Bankën Popullore.

(2) Nëse instrumenti për shpërndarjen e brendshme të humbjeve aplikohet për ndërhyrje të jashtëzakonshme ndajdy ose më shumë anëtarëve të të njëjtit grup në Republikën e Maqedonisë së Veriut, planin e riorganizimit e harton shoqëria amë dhe vlen për të gjithë anëtarët e grupit dhe i dorëzohet organit kompetent për ndërhyrje të jashtëzakonshme të grupit në afatin të paragrafit (1) të këtij neni. Organi kompetent për ndërhyrje të jashtëzakonshme të grupit planin e riorganizimit nga ky paragraf u'a dorëzon organeve kompetente për ndërhyrje të jashtëzakonshme ndaj të gjithë anëtarëve të grupit.

(3) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, Banka Popullore mund të lejoj një periudhë shtesë prej dy muajsh për përgatitjen e planit për riorganizim nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, nëse është e nevojshme për arritjen e qëllimeve të ndërhyrje të jashtëzakonshme.

(4) Plani i riorganizimit përmban masat që duhet të ndërmerren për të rivendosur funksionimin normal të bankës që shpërbëhet ose pjesë e veprimtarisë së saj, në afat të gjatë. Masat duhet të bazohen në supozime realiste për situatën ekonomike dhe gjendjen e tregut financiar duke përfshirë identifikimin e mangësive më të rëndësishme dhe problemeve të mundshme të bankës që po trajtohet.

(5) Plani i riorganizimit përfshin sëpaku elementet në vijim:

1) vlerësimin e detajuar të faktorëve, problemeve dhe kushteve që i shkaktohen bankës që vendos të përmbushë huat e nenit 19, paragrafi (1), pika 1) të këtij ligji;

2) përshkrimin e masave që duhet të ndërmerren për të rivendosur funksionimin normal të bankës në afat të gjatë;

3) dinamikën/kornizën kohore për zbatimin e këtyre masave.

(6) Masat të paragrafit (5), pika 2 të këtij neni mund të përfshijnë:

-riorganizimin e mënyrës së funksionimit të bankës që po ndërhyhet;

-ndryshimet në strukturën organizative dhe sistemet operative të bankës në ndërhyrje të jashtëzakonshme;

-ndërprerjen e aktiviteteve që sjellin humbje në bankën që po ndërhyhet;

-ristrukturimin e aktiviteteve të kryera nga banka/produktet dhe shërbimet e ofruara nga banka me qëllim rritjen e konkurrencës së tyre;

-shitja e aseteve ose e linjave të biznesit të bankës në ndërhyrje të jashtëzakonshme;

-aktivitete të tjera me qëllim rivendosjen e funksionimit normal të bankës në periudhë afatgjatë.

(7) Banka Popullore më së voni në afat prej një muaji pas marrjes së planit për riorganizim e miraton planin e dorëzuar për riorganizim nëse vlerëson se zbatimi i tij do të mundësojë rivendosjen e funksionimit normal të bankës në afat të gjatë.

(8) Nëse Banka Popullore vlerëson se me zbatimin e planit për riorganizim nuk do të realizohen qëllimet të paragrafit (7) të këtij neni, do t'i dërgojë njoftim këshillit drejtues të bankës ose personave përgjegjës për ushtrimin e kompetencave të nenit 59, paragrafi (1) të këtij ligji, me të cilin do të kërkojë rishikimin e duhur të planit të riorganizimit.

(9) Në afat prej dy javësh pas marrjes së njoftimit të paragrafit (8) nga ky nen, këshilli drejtues nga bankat ose personat e autorizuar për kryerjen e kompetencave nga një neni 59, paragrafi (1) të këtij ligji janë të detyruar të dorëzojnë planin e ripërpunuar për riorganizim Bankës Popullore. Në afat prej 1 jave Banka Popullore do të informoj këshillin drejtues e bankës ose

personat e autorizuar të nenit 59, paragrafi (1) të këtij ligji nëse e miraton planin ose nëse ka nevojë i njejtë të plotësohet ose ripërpunohet.

(10) Këshilli drejtues i bankës ose personat përgjegjës për ushtrimin e kompetencave të nenit 59, paragrafi (1) të këtij ligji janë të detyruar që t'a zbatojnë planin e miratuar për riorganizim, duke përfshirë planin e riorganizuar të paragrafit (12) të këtij neni dhe të dorëzojnë raporte në Bankën Popullore për zbatimin e tij, së paku në çdo gjashtë muaj (së paku dy herë në vit).

(11) Këshilli drejtues i bankës ose personat përgjegjës për ushtrimin e kompetencave të nenit 59, paragrafi (1) të këtij ligji janë të detyruar që ta rishikojnë planin e miratuar për riorganizim, nëse gjatë zbatimit të tij marrin njoftim nga Banka Popullore se kjo është e nevojshme për arritjen e qëllimeve të paragrafit (4) të këtij neni.

(12) Planin e rishikuar për riorganizim të paragrafit (11) të këtij neni e shqyrton dhe e miraton Banka Popullore në afatet të paragrafit (9) të këtij neni.

(13) Nëse procedura e ndërhyrjes së jashtëzakonshme të bankës parasheh zbatimin e rregulloreve që rregullojnë përdorimin e ndihmës shtetërore dhe përgatitjen e planit të ristrukturimit për këtë qëllim, plani i riorganizimit të bankës nga ky nen duhet të harmonizohet me planin që është paraqitur në procedurën e vlerësimit të ndihmës shtetërore.

(14) Këshilli i Bankës Popullore e përcakton përmbajtjen dhe mënyrën e vlerësimit të planit të riorganizimit me akt nënligjor, përkatësisht, në përputhje me paragrafin (5) të këtij neni dhe përmbajtjen e raporteve të paragrafit (10) të këtij neni.

(15) Me përjashtim të nenit 23, paragrafi (19), pika 1) të këtij ligji, nëse Banka Popullore e konsideron të nevojshme, periudha e emërimit të administratës speciale vazhdon për shkak të përfshirjes së saj në përgatitjen e planit për riorganizim dhe zbatimin e masave të parashikuara në plan.

Efektet e shpërndarjes të brendshëm të humbjeve

Neni 41

(1) Zvogëlimi i shumës së principalit ose i shumës së papaguar dhe konvertimi i instrumenteve përkatëse të kapitalit dhe detyrimeve të lejuara ose tërheqja e instrumenteve përkatëse, të kryera në përputhje me nenin 43, paragrafi (1) dhe nenin 48, paragrafi (2), pika 7) deri në 11) të këtij ligji, janë të detyrueshme për bankën që ndërhyhet dhe kreditorët ose akcionerët të arkëtueshmet, respektivisht instrumentet fshihen, konvertohen ose tërhiqen.

(2) Banka Popullore ka autoritet të zbatojë ose të kërkojë zbatimin e të gjitha veprimeve dhe procedurave administrative me qëllim të kryerjes së punëve të nenit 43, paragrafi (1) dhe neni 48, paragrafi (2), pikat 7) deri në 11) të këtij ligji, duke përfshirë:

- ndryshime në regjistrat përkatës;

- heqja e instrumenteve të kapitalit dhe borxhit nga kuotimet në tregun zyrtar ose nga tregu i rregullt;

- futja e instrumenteve të reja të pronësisë dhe borxhit në kuotat në tregun zyrtar, pra hyrje në tregun e rregullt;

- rifutja e instrumenteve të borxhit që janë hequr nga tregu zyrtar, pra ripranimi i tyre në tregun e rregullt, pa detyrimin e dhënies të prospektit në përputhje me ligjin që rregullon veprimtarinë e obligacioneve.

(3) Të gjitha institucionet dhe personat të cilëve Banka Popullore ka paraqitur kërkesë për realizimin e aktiviteteve të paragrafit (2) të këtij neni, janë të detyruar që pa vonesë të veprojnë sipas kërkesës së paraqitur.

(4) Nëse Banka Popullore kryen zvogëlim të plotë të shumës së principalit ose shumës së papaguar të detyrimit në përputhje me nenin 48, paragrafi (2), pika 7) të këtij ligji, ai detyrim, së bashku me çdo detyrim tjetër ose hua që lidhet me të, i cili nuk është i papaguar në ditën kur Banka Popullore e ka kryer uljen, konsiderohet se është arkëtuar dhe nuk mund të vërtetohet në ndonjë procedurë të mëvonshme të shlyerjes së bankës në rikthimin e suksesit të saj ose në procedurën e mëvonshme.

(5) Nëse Banka Popullore kryen zvogëlimin e pjesshëm të principalit ose të shumës së papaguar të detyrimit në përputhje me nenin 48, paragrafi (2), pika 7) të këtij ligji, detyrimi konsiderohet se është arkëtuar në vlerën e shumës së zvogëluar, ndërsa pjesa e mbetur e detyrimit vazhdon të përmbushet në përputhje me kontratën, duke marrë parasysh ndryshimet e bëra në lidhje me kamatën për shkak të zvogëlimit të principalit, si dhe të çdo ndryshimi tjetër që mund të bëjë Banka Popullore, në përputhje me nenin 48, paragrafi (2), pika 12) të këtij ligji.

Njohja kontraktuese e shpërndarjes së brendshme të humbjeve

Neni 42

(1) Banka është e detyruar në kontratën për emetimin, respektivisht për marrjen e detyrimit, të përfshijë dispozita përkatëse në bazë të të cilave kreditori ose pala tjetër kontraktuese do të dinë se detyrimi mund të jetë objekt shlyerjeje ose konvertimi dhe të cilat konfirmojnë se kreditori ose pala tjetër kontraktuese janë dakord për çdo reduktim të shumës së principalit ose të detyrimit të papaguar, me të cilin mund të tërhiqet detyrimi i cili është objekt i kontratës, ndërsa të cilin mund të kryej Banka Popullore, ndërsa detyrimi plotëson kushtet e mëposhtme:

- 1) nuk përjashtohet në përputhje me nenin 32, paragrafi (2) të këtij ligji;
- 2) depozita që tejkalon shumën e kompensimit nuk është e siguruar;
- 3) për të zbatohen dispozitat ligjore të një vendi tjetër dhe
- 4) është lëshuar ose pranuar pas datë së hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(2) Banka Popullore mund të vendos që dispozitat e paragrafit (1) të këtij neni të mos zbatohen për bankën për të cilën shkalla minimale e mjeteve vetjake dhe e detyrimeve të lejuara të nenit 10 të këtij ligji caktohet vetëm në bazë të shumës për mbulimin e humbjeve, në përputhje me nenin 12 paragrafi (3) të këtij ligji, por vetëm nëse detyrimet të paragrafit (1) të këtij neni nuk merren parasysh me rastin e përcaktimit të përmbushjes së normës minimale të mjeteve vetjake dhe detyrimeve të lejuara.

(3) Dispozitat e paragrafit (1) të këtij neni nuk zbatohen për detyrimet që mund të shlyhen në bazë të ligjit nga shteti tjetër ose në bazë të kontratës së lidhur me shtetin tjetër.

(4) Banka është e detyruar t'a njoftojë Bankën Popullore nëse konstaton se për shkak të ndonjë pengese juridike ose tjetër nuk mund të përfshijë dispozita përkatëse të paragrafit (1) të këtij neni, me të cilat specifikohet lloji i detyrimit të cilit i referohet.

(5) Krahas njoftimit të paragrafit (4) të këtij neni, banka i paraqet Bankës Popullore sqarim të detajuar për pengesën e konstatuar në zbatimin e dispozitave të paragrafit (1) të këtij neni dhe me kërkesë të Bankës Popullore dorëzon informata shtesë dhe/ose dokumentacion në bazë

të të cilit Banka Popullore do të mund të përcaktojë efektin e njoftimit të tillë mbi mundësinë e bankës për të ndërhyrë.

(6) Nga dita kur Banka Popullore e ka pranuar njoftimin të paragrafit (4) të këtij neni, detyrimi për përfshirjen e dispozitave përkatëse në përputhje me paragrafin (1) të këtij neni pushon në lidhje me detyrimet për të cilat bëhet fjalë në njoftim.

(7) Nëse Banka Popullore, në bazë të informatave dhe dokumentacionit të dorëzuar në përputhje me paragrafin (5) të këtij neni, konstaton se nuk ka pengesë juridike ose tjetër për zbatimin e dispozitave të paragrafit (1) të këtij neni, do të kërkojë nga banka që dispozitat e paragrafit (1) të këtij neni t'i zbatojë në detyrimet e paragrafit (4) të këtij neni, si dhe ndryshimet e duhura në praktikë të bankës për zbatimin e përjashtimeve nga e marrëveshja për shpërndarjen e humbjeve të brendshme.

(8) Nëse Banka Popullore konstaton se në kuadër të një kategorie të caktuar të detyrimeve, shumat e detyrimeve të paragrafit (1) të këtij neni, së bashku me shumën e detyrimeve të asaj klase që përjashtohen nga detyrimet për shpërndarjen e brendshme të humbjeve në përputhje me nenin 32, paragrafi (2) ose që mund të përjashtohen nga Banka Popullore në përputhje me nenin 33 të këtij ligji, mund të ketë efekt mbi 10% të kësaj kategorie të ndërhyrjes së jashtëzakonshme të bankës, duke përfshirë dhe ndikimin që mund të ketë rreziku i mosrespektimit të masave mbrojtëse të nenit 61 të këtij ligji, gjatë zbatimit të fshirjes ose konvertimit të detyrimeve të lejuara.

(9) Nëse Banka Popullore konstaton se rastet e këtij neni paraqesin pengesa domethënëse në mundësinë e ndërhyrjes së jashtëzakonshme të bankës, ajo merr masat përkatëse në përputhje me nenin 9 të këtij ligji.

(10) Detyrimet që nuk plotësojnë ose që në përputhje me këtë nen nuk zbatohen për huat të paragrafit (1) të këtij neni, nuk mund të përfshihen në përmbushjen e normës minimale të mjeteve vetjake dhe detyrimeve të lejuara të nenit 10 të këtij ligji.

(11) Banka Popullore mund të kërkojë nga banka mendim juridik lidhur me bazën juridike për zbatimin e dispozitave të paragrafit (1) të këtij neni.

(12) Banka Popullore mund t'a shlyejë ose t'a shndërrojë detyrimin të paragrafit (1) të këtij neni, edhe në rastet kur banka nuk i ka përfshirë dispozitat përkatëse kontraktuese në përputhje me paragrafin (1) të këtij neni.

KAPITULLI IV

SHLYERJA DHE SHËNDRIMI I INSTRUMENTEVE TË KAPITALEVE PËRKATËSE DHE DETYRIMEVE TË LEJUARA

Kushtet për shlyerjen ose shëndrimin e instrumenteve përkatëse të kapitalit dhe të detyrimeve të lejuara

Neni 43

(1) Banka Popullore mund të marrë vendim për shlyerjen ose shndërrimin e instrumenteve përkatëse kapitale ose detyrimet e lejuara të paragrafit (3) të këtij neni, të lëshuara nga banka, në aksione ose instrumente të tjera pronësore të bankës ose të personit tjetër juridik të nenit 2, paragrafi (1) të këtij ligji:

1) pavarësisht nga aktivitetet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme ose

2) së bashku me ndërmarrjen e veprimeve të ndërhyrje të jashtëzakonshme kur plotësohen kushtet për ndërhyrje të jashtëzakonshme nga nenet 19 ose 20 të këtij ligji.

(2) Pas aplikimit të autorizimit për fshirjen dhe konvertimin e instrumenteve kapitale përkatëse ose detyrimeve të lejuara të paragrafit (3) të këtij neni, në përputhje me paragrafin (1), pika 1) të këtij neni, bëhet vlerësimi të nenit 61 të këtij ligji dhe zbatohet neni 62 të këtij ligji.

(3) Këshilli i Bankës Popullore me akt nënligjor më hollësisht i përcakton kushtet që duhet t'i plotësojnë detyrimet e lejuara në lidhje me të cilat mund të kryhet shlyerja ose shndërrimi i detyrimeve të lejuara të paragrafit (1) të këtij neni, duke marrë parasysh parimin të nenit 18, paragrafi (1), pika 8) të këtij ligji. Me akt nënligjor parashikohet gjithashtu mënyra e fshirjes dhe konvertimit të instrumenteve të duhura kapitale dhe detyrimeve të lejuara.

(4) Me rastin e shlyerjes ose shndërrimit të instrumenteve përkatëse kapitale ose të detyrimeve të lejuara të paragrafit (3) të këtij neni, përkatësisht zbatohen dispozitat e nenit 36 të këtij ligji. (5) Kur ndërmerren veprime të shlyerjes ndaj bartësit të shlyerjes, shuma e cila zvogëlohet, shlyhet ose konvertohet në përputhje me nenin 44, paragrafi (1) të këtij ligji, merret parasysh me rastin e përcaktimit të kufijve të nenit 24, paragrafi (6), pika 1) dhe neni 34, paragrafi (2), pika 1) ose të nenit 34, paragrafi (6), pika 1) e këtij ligji, të cilat janë të zbatueshme për bartësin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

(6) Banka Popullore realizon shlyerjen ose shndërrimin e instrumenteve përkatëse kapitale ose të detyrimeve të lejuara të paragrafit (3) të këtij neni, të lëshuara nga banka ose personi tjetër juridik të nenit 2, paragrafi (1) të këtij ligji, në përputhje me nenin 44 të këtij ligji dhe pa vonesë, nëse vlerëson se është plotësuar së paku njëri nga kushtet si në vijim:

1) janë plotësuar kushtet për shlyerje të nenit 19 të këtij ligji;

2) banka ose grupi bankar nuk do të mund të vazhdojnë punën nëse nuk kryhet shlyerja ose konvertimi i instrumenteve përkatëse kapitale ose detyrimeve të lejuara të paragrafit (3) të këtij neni;

3) Bankës i nevojitet ndihmë financiare e jashtëzakonshme publike, me përjashtim të ndihmës së parashikuar në nenin 19, paragrafi (2), pika 4) të këtij ligji.

(7) Në rastet të paragrafit (6), pika 1) të këtij neni, Banka Popullore kryen shlyerjen ose konvertimin e instrumenteve përkatëse kapitale ose të detyrimeve të lejuara para se të ndërmarrë ndonjë veprim për ndërhyrje të jashtëzakonshme.

(8) Për qëllime të paragrafit (6), pika 2) të këtij neni, konsiderohet se banka ose grupi bankar nuk do të mund të vazhdojë veprimtarinë, nëse plotësohen dy kushtet e mëposhtme:

1) në lidhje me bankën është plotësuar një nga kushtet të nenit 19, paragrafi (2) të këtij ligji, respektivisht grupi bankar nuk plotëson ose ka rrethana objektive që tregojnë se së shpejti nuk do të përmbushë huat e ligjit që rregullon veprimtarinë e bankave në baza të konsoliduara, në masën që justifikon marrjen e masave super mbikëqyrëse, në përputhje me atë ligj duke përfshirë edhe arsyen për çka grupi ka pësuar humbje ose ka gjasa të mëdha të pësoj humbje me çka do plotësisht ose pjesërisht do të zvogëlohen mjetet e saj vetanak si dhe

2) nisur nga rrethanat, nuk ka gjasa që marrja e ndonjë mase, duke përfshirë masat mbikëqyrëse ose masat të iniciuara nga sektori privat, do të parandalonte ndërprerjen e punës së bankës ose grupit bankar brenda një periudhe të arsyeshme kohore.

(9) Para kryerjes së shlyerjes ose shndërrimit të instrumenteve përkatëse kapitale ose të detyrimeve të lejuara të paragrafit (3) të këtij neni, Banka Popullore bën vlerësim të mjeteve dhe detyrimeve të bankës në përputhje me nenin 21 të këtij ligji. Në bazë të vlerësimit, përcaktohet shuma e shlyerjes së instrumenteve kapitale përkatëse ose e detyrimeve të lejuara të paragrafit

(3) të këtij neni që kërkohet për të mbuluar humbjet dhe niveli i konvertimit të instrumenteve përkatëse kapitale ose detyrimet e lejuara të paragrafit (3) të këtij neni që kërkohet për rikapitalizimin e bankës.

Zbatimi i shlyerjes ose konvertimit të instrumenteve kapitale dhe detyrimeve të lejuara

Neni 44

(1) Banka Popullore shlyerjen ose konvertimin e instrumenteve përkatëse kapitale ose të detyrimeve të lejuara të nenit 43, paragrafi (3) të këtij ligji e zbaton në mënyrë të kundërt nga radhitja e ndërhyrjes së jashtëzakonshme të borxheve në procedurat e falimentimit të bankës, në këtë mënyrë:

1) së pari zvogëlohen instrumentet e kapitalit bazë të rregullt, në raport me shumën e humbjeve me shumën e kapitalit bazë të rregullt dhe Banka Popullore ndaj aksionarëve të bankës ndërmerr njërën ose të dyja masat të nenit 36, paragrafi (1) të këtij ligji ndaj aksionerëve të bankës;

2) principi i instrumenteve të kapitalit bazë plotësues shlyhet dhe/ose shndërrohet në instrument të kapitalit bazë të rregullt, deri në shumën e nevojshme për arritjen e objektivave të ndërhyrjes së jashtëzakonshme të bankës ose deri në shumën totale të këtyre instrumenteve kapitale, varësisht se cila shumë është më e ulët;

3) principi i instrumenteve të kapitalit shtesë shlyhet dhe/ose shndërrohet në instrument të kapitalit të rregullt bazë, deri në shumën e nevojshme për arritjen e objektivave të ndërhyrjes së jashtëzakonshme të bankës ose deri në shumën totale të këtyre instrumenteve kapitale, varësisht se cila shumë është më e ulët;

4) principi i detyrimeve të lejuara të nenit 43, paragrafi (3) të këtij ligji shlyhet dhe/ose shndërrohet në instrument të kapitalit bazë të rregullt, deri në shumën e nevojshme për arritjen e qëllimeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme të bankës ose deri në shumën e përgjithshme të detyrimeve përkatëse të lejuara, varësisht se cila shumë është më e ulët.

(2) Me rastin e fshirjes së instrumenteve përkatëse kapitale ose të detyrimeve të lejuara të nenit 43, paragrafi (3) të këtij ligji:

1) shlyerja është e përhershme, me mundësi të rritjes së vlerës në përputhje me nenin 35, paragrafi (4) të këtij ligji;

2) ndaj poseduesit të instrumentit kapital përkatës ose detyrimit të lejuar të nenit 43, paragrafi (3) të këtij ligji pushojnë në lidhje me shumën e shlyer të instrumentit kapital ose detyrimin e lejuar, përveç detyrimeve të llogaritura tashmë dhe detyrimeve për kompensimin e dëmit të përcaktuara në procedurën e nisur pas padisë kundër ligjshmërisë së shlyerjes së kryer;

3) bartësit të instrumentit kapital përkatës ose detyrimit të lejuar të nenit 43, paragrafi (3) të këtij ligji nuk do t'i paguhet kompensim përveç në përputhje me paragrafin (3) të këtij neni.

(3) Banka Popullore për kryerjen e konvertimit të instrumenteve përkatëse kapitale dhe detyrimeve të lejuara të nenit 43, paragrafi (3) nga ky ligj, në përputhje me paragrafin (1), pikat 2), 3) dhe 4) të këtij neni, Banka Popullore mund t'a urdhërojë bankën që të emetojë instrumente të kapitalit të rregullt bazë për poseduesit e instrumenteve kapitale përkatëse dhe detyrimeve të lejuara. Instrumentet përkatëse të kapitalit dhe detyrimet e lejuara mund të konvertohen në instrumente të rregullta të kapitalit bazë në kushtet e mëposhtme:

1)ato instrumente të kapitalit bazë të rregullt të lëshuar nga banka ose shoqëria e saj amë me pëlqimin paraprak të Bankës Popullore, ose nëse është e mundur, me pëlqimin e organit për ndërhyrje të jashtëzakonshme ndajshoqërisë amë;

2)këto instrumente të kapitalit bazë të rregullt duhet të emetohen përpara se banka të emetojë aksione ose instrumente të tjera pronësie për qëllime të dhënies së ndihmës shtetërore për rikapitalizim;

3)ato instrumente të kapitalit të rregullt bazë caktohen dhe barten pa vonesë pas zbatimit të autorizimit për konvertimin e instrumenteve përkatëse kapitale ose detyrimeve të lejuara;

4)kursi i konvertimit në bazë të të cilit përcaktohet numri i instrumenteve nga kapitali i rregullt bazë që ndahen për çdo instrument përkatës kapital ose çdo detyrim të lejuar është në përputhje me parimet e nenit 39 të këtij ligji dhe aktin nënligjor të miratuar në bazë të atij neni.

(4) Për sigurimin e instrumenteve të kapitalit të rregullt bazë në përputhje me paragrafin (3) të këtij neni, Banka Popullore mund t'a detyrojë bankën që t'i sigurojë të gjitha miratimet e nevojshme paraprake nga organet kompetente për emetimin e numrit të nevojshëm të instrumenteve të kapitalit të rregullt bazë.

(5) Nëse nga shëndrimi i instrumenteve përkatëse kapitale dhe i detyrimeve të lejuara rezulton fitimi i pjesëmarrjes së kualifikuar ose rritja e pjesëmarrjes së kualifikuar në bankë, do të zbatohen dispozitat e nenit 36, paragrafët (5) dhe (6) të këtij ligji.

(6) Këshilli i Bankës Popullore përcakton llojin e dokumentacionit, kushtet dhe procedurën për dhënien e pëlqimit të paragrafit (3), pika 1) të këtij neni.

KAPITULLI V

INSTRUMENTET SHTETËRORE PËR STABILIZIM FINANCIAR

Instrumentet shtetërore për stabilizimin financiar

Neni 45

(1) Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut/Ministria e Financave mund të ofrojë ndihmë të jashtëzakonshme financiare publike përmes instrumenteve shtetërore për stabilizim financiar, duke e përfshirë në procedurën e ndërhyrjes së jashtëzakonshme të bankës për të shmangur hapjen e procedurës së falimentimit dhe për të arritur qëllimet e vendimit të nenit 17, paragrafi (1) të këtij ligji.

(2) Instrumentet shtetërore për stabilizim financiar përdoren vetëm nëse plotësohen kushtet e nenit 24, paragrafi (6) të këtij ligji dhe në përputhje me dispozitat që rregullojnë përdorimin e ndihmës shtetërore, si mjet i fundit pasi të jenë marrë parasysh instrumentet e tjera të ndërhyrjes së jashtëzakonshme të bankave.

(3) Instrumentet shtetërore për stabilizimin financiar janë:

1)ndihma shtetërore për rikapitalizim dhe

2)pronësia e përkohshme shtetërore.

(4) Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut/Ministria e Financave, në bazë të informatave nga Banka Popullore për gjendjen financiare të bankës dhe masat e marra ndaj bankës, si dhe në bazë të rekomandimit/kërkesës nga Banka Popullore, mund të vendosë për zbatimin e instrumenteve shtetërore për stabilizim financiar nëse kushtet të nenit 19, paragrafi (1) të këtij ligji dhe një nga kushtet e mëposhtme:

1) Ministria e Financave dhe Banka Popullore kanë konstatuar se aplikimi i instrumenteve të ndërhyrje të jashtëzakonshme nuk do të jetë i mjaftueshëm për të parandaluar një ndikim të rëndësishëm negativ në sistemin financiar ose

2) Ministria e Financave dhe Banka Popullore kanë përcaktuar se zbatimi i instrumenteve të ndërhyrje të jashtëzakonshme nuk do të jetë i mjaftueshëm për mbrojtjen e interesit publik, në rastet kur bankës tashmë i është dhënë mbështetje likuiditeti në rrethana të jashtëzakonshme nga Banka Popullore.

(5) Instrumentet shtetërore për stabilizim financiar i përcakton dhe i zbaton Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut/Ministria e Financave, në bashkëpunim me Bankën Popullore, me kusht që të jetë miratuar dhënia e ndihmës së jashtëzakonshme financiare publike në përputhje me dispozitat që rregullojnë përdorimin e ndihmës shtetërore.

(6) Për shkak të zbatimit të instrumenteve shtetërore për stabilizim financiar, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut/Ministria e Financave ka kompetencat përkatëse në procedurën e ndërhyrjes së jashtëzakonshme të bankës nga Kapitulli VI i ligji.

Ndihma shtetërore për rikapitalizim

Neni 46

(1) Në përputhje me ligjin që rregullon shoqëritë tregtare, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut/Ministria e Financave në emër të Republikës së Maqedonisë së Veriut, mund të marrë pjesë në rikapitalizimin e bankës mbi të cilën ndërhyhet në mënyrë të jashtëzakonshme, duke investuar mjete monetare në këmbim të:

- 1) instrumenteve të kapitalit të rregullt bazë;
- 2) instrumenteve shtesë të kapitalit bazë ose
- 3) instrumenteve plotësuese të kapitalit.

(2) Në varësi të aksioneve të Republikës së Maqedonisë së Veriut në bankë, Ministria e Financave është e detyruar të sigurojë që banka në të cilën aplikohet instrumenti i ndihmës shtetërore për rikapitalizim të menaxhohet me vëmendjen e tregtarit të rregullt dhe të ndërgjegjshëm.

(3) Nëse përdoret instrumenti i ndihmës shtetërore për rikapitalizim, Ministria e Financave është e detyruar të sigurojë aksionet e Republikës së Maqedonisë së Veriut në bankë, e cila vendoset t'i shitet blerësit privat, sapo të krijohen kushtet për shitje.

Pronësia e përkohshme shtetërore

Neni 47

(1) Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut/Ministria e Financave mund t'a kalojë bankën mbi të cilën bëhet ndërhyrja e jashtëzakonshme në pronësi të përkohshme shtetërore. Ky instrument zbatohet vetëm nëse bankës tashmë i është dhënë ndihma shtetërore për rikapitalizim dhe Ministria e Financave dhe Banka Popullore kanë përcaktuar se aplikimi i instrumenteve të ndërhyrje të jashtëzakonshme nuk do të jetë i mjaftueshëm për mbrojtjen e interesit publik.

(2) Në rastet e paragrafit (1) të këtij neni, Ministria e Financave lëshon një ose më shumë urdhëra për Depozitën qendrore për kalimin e aksioneve në bankën, shoqëri në pronësi të plotë të shtetit, të cilën Depozita qendrore për letra me vlerë i zbaton pa vonesë.

(3) Ministria e Financave është e detyruar të sigurojë që banka e cila zgjidhet, në të cilën zbatohen instrumentet të paragrafit (1) të këtij neni, të menaxhohet me vëmendjen e tregtarit të rregullt dhe të ndërgjegjshëm dhe t'i shitet blerësit privatë posa të krijohen kushtet për shitje.

KAPITULLI VI

KOMPETENCAT E BANKËS POPULLORE SI ORGAN KOMPETENT PËR NDËRHYRJE TË JASHTËZAKONSHME

Kompetencat e përgjithshme

Neni 48

(1) Banka Popullore ka të drejtë të ketë çasje në të gjitha të dhënat dhe informacionet e nevojshme për përgatitjen dhe zbatimin e veprimeve të ndërhyrje të jashtëzakonshme, si dhe për përditësimin dhe plotësimin e planeve të ndërhyrje të jashtëzakonshme, ndërsa banka, të punësuarit në bankë, aksionarët dhe personat e tjerë janë të detyruar t'i sigurojnë çasje në të dhe t'i sigurojnë të gjitha të dhënat dhe informacionin e nevojshëm për kryerjen e kompetencave të saj, si dhe t'i sigurojnë çasje deri tek hapësirat e bankës përshkak të zbatimit të kontrollit të paragrafit (2) të këtij neni.

(2) Banka Popullore si organ për ndërhyrje të jashtëzakonshme mund të ushtrojë këto kompetenca individualisht ose në kombinim:

1) të kërkojë dhe të ofrojë të dhëna dhe informacione në përputhje me paragrafin (1) të këtij neni, duke përfshirë kontrollin në terren lidhur me bankën për ndërhyrje të jashtëzakonshme në përputhje me ligjin që rregullon punën e bankave, si dhe të vendosë masa për zbatimin e këtij ligji, në përputhje me nenin 9 të këtij ligji;

2) të zbatojë instrumentet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme të bankave të përcaktuara në këtë ligj;

3) të marrë kompetencat e mbledhjes së aksionarëve, këshillit mbikëqyrës dhe këshillit drejtues të bankës mbi të cilën ndërhyhet në mënyrë të jashtëzakonshme;

4) të shkarkojë anëtarët e këshillit mbikëqyrës dhe/ose drejtues të bankës mbi të cilën ndërhyhet në mënyrë të jashtëzakonshme, si dhe të shkarkojë një person me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta në bankë;

5) të transferojë aksionet ose instrumentet e tjera pronësore të lëshuara nga banka që është në ndërhyrje të jashtëzakonshme;

6) me pëlqimin e tij t'i transferojë mjetet, të drejtat ose detyrimet e bankës mbi të cilën ndërhyhet në mënyrë të jashtëzakonshme te një person tjetër;

7) të zvogëlojë plotësisht ose pjesërisht shumën e principalit ose shumën e papaguar të detyrimeve për shpërndarjen e brendshme të bankës që është në ndërhyrje të jashtëzakonshme;

8) të shndërrojë detyrimet për shpërndarjen e brendshme të bankës mbi të cilën ndërhyhet në mënyrë të jashtëzakonshme në aksione ose instrumente të tjera pronësie të asaj banke, shoqërisë amë të saj ose institucionit kalimtar të cilit i janë bartur mjetet, të drejtat ose detyrimet e bankës mbi të cilën ndërhyhet në mënyrë të jashtëzakonshme;

9) të anulojë instrumentet e borxhit të lëshuara nga banka që është në ndërhyrje të jashtëzakonshme, përveç detyrimeve të përjashtuara në përputhje me nenin 32, paragrafi (2) të këtij ligji;

10) të zvogëlojë plotësisht ose pjesërisht vlerën nominale të aksioneve ose të instrumenteve të tjera pronësore të lëshuara nga banka që është në ndërhyrje të jashtëzakonshme ose të tërheqë aksionet;

11) të udhëzojë bankën në ndërhyrje të jashtëzakonshme ose personit amë të saj të emetojë aksione të reja ose instrumente të tjera të kapitalit ose instrumente të tjera kapitale, duke përfshirë aksionet e preferuara dhe obligacionet të konvertueshme;

12) të ndryshojë afatin e maturimit të instrumenteve të huadhënies dhe detyrimeve të tjera për shpërndarje të brendshme të lëshuara nga banka që është në ndërhyrje të jashtëzakonshme, të ndryshojë normën e interesit të atyre instrumenteve dhe detyrimeve dhe datën në të cilën duhet të paguhet kamata, duke përfshirë edhe shtyrjen e përkohshme të pagesës, përveç detyrimeve të përjashtuara në përputhje me nenin 32, paragrafi (2) të këtij ligji;

13) të skadojë ose mbyllë kontratat financiare ose kontratat për derivativët financiarë për të zbatuar nenin 38 të këtij ligji.

(3) Kontrollin në terren të paragrafit (2), pika 1) të këtij neni e kryejnë personat e punësuar në Bankën Popullore.

(4) Këshill i Bankës Popullore me akt nënligjor më hollësisht i përcakton mënyrën e kryerjes së kontrollit në terren dhe shqiptimin e masave të paragrafit (2), pika 1) të këtij neni.

(5) Nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe, me rastin e zbatimit të kompetencave dhe instrumenteve për ndërhyrje të jashtëzakonshme në përputhje me këtë ligj, për Bankën Popullore nuk vlejnë dispozitat e ligjeve të tjera dhe të kontratave të lidhura që kanë të bëjnë me këto çështje:

1) detyrimi për të marrë pëlqimin ose miratimin nga organi kompetent ose nga çdo person juridik ose fizik, duke përfshirë aksionarët dhe kreditorët e bankës mbi të cilën ndërhyhet në mënyrë të jashtëzakonshme;

2) detyrimi për të paraqitur të dhëna, duke përfshirë publikimin e një njoftimi ose prospekti ose paraqitjen dhe regjistrimin e ndonjë dokumenti në një organ kompetent dhe

3) kufizime për transferimin ose detyrimin për të marrë pëlqimin për transferimin e instrumenteve financiare, të drejtave, mjete ose detyrimeve.

Autorizime shtesë

Neni 49

(1) Nëse vlerëson se është e nevojshme për arritjen e një ose më shumë nga qëllimet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, Banka Popullore në procedurën për ndërhyrje të jashtëzakonshme ndajnjë banke është e autorizuar që:

1) të sigurojë që instrumentet financiare, mjetet, të drejtat ose detyrimet të barten pa ndonjë detyrim ose barrë që i prek ato, përveç rasteve të nenit 63 të këtij ligji, ku e drejta për kompensim në përputhje me këtë ligj nuk konsiderohet për detyrim;

2) të heq të drejtën për të blerë aksione të reja ose instrumente të tjera pronësie;

3) të kërkojë nga institucioni kompetent ndalimin e tregtimit të obligacioneve të bankës mbi të cilën ndërhyhet në mënyrë të jashtëzakonshme dhe ta përjashtojë bankën nga tregu i rregullt dhe zyrtar;

4) të kërkojë nga institucioni kompetent që të mos kryejë transferimin e obligacioneve, me përjashtim të transaksioneve komerciale të lidhura para miratimit të vendimit për fillimin e procedurës për ndërhyrjen e jashtëzakonshme mbi bankën të nenit 22 të këtij ligji;

5) të sigurojë që shoqëria marrëse të trajtohet në të njëjtën mënyrë si banka ndaj të cilës bëhet ndërhyrje e jashtëzakonshme, në lidhje me çdo të drejtë ose detyrim të bankës ose veprime të ndërmarra nga banka, përfshirë të drejtat dhe detyrimet që lidhen me pjesëmarrjen në infrastrukturën e tregut, në përputhje me nenet 26 dhe 28 të këtij ligji;

6) të udhëzojë bankën mbi të cilën bëhet ndërhyrja e jashtëzakonshme ose shoqërinë pranuese që të shkëmbejnë informacione reciproke;

7) të zgjidhë kontratën ose të ndryshojë kushtet e kontratës të lidhur nga banka që është në ndërhyrje të jashtëzakonshme ose të sigurojë që shoqëria marrëse të zërë vendin e saj si palë kontraktuese.

(2) Për të siguruar vazhdimësinë e veprimtarisë që bartet, Banka Popullore ka të drejtë të urdhërojë:

1) vazhdimin e kontratave të lidhura nga banka që është në ndërhyrje të jashtëzakonshme, në atë mënyrë që shoqëria marrëse të marrë përsipër të drejtat dhe detyrimet në lidhje me instrumentet financiare, mjetet, të drejtat dhe detyrimet që janë transferuar dhe hyn si palë kontraktuese në vend të bankës mbi të cilën ndërhyhet në mënyrë të jashtëzakonshme;

2) shoqëria marrëse të zë vendin e bankës me të cilën trajtohet në të gjitha proceset gjyqësore që lidhen me instrumentet financiare, mjetet, të drejtat ose detyrimet që i janë transferuar nga banka.

(3) Kompetencat të paragrafit (1), pika 4) dhe paragrafi (2), pika 2) të këtij neni nuk ndikojnë në:

1) të drejtën e punonjësit të bankës që vendos të anulojë kontratën për punësim;

2) ushtrimi i të drejtave të një pale kontraktuese, duke përfshirë të drejtën për të zgjidhur kontratën e lidhur me bankën mbi të cilën bëhet ndërhyrja e jashtëzakonshme, nëse kjo parashikohet në kontratë, për shkak të një veprimi ose lëshimit të ndërmarrjes së një veprimi të bankës në ndërhyrje të jashtëzakonshme përpara transferimit, respektivisht nga shoqëria marrëse pas transferimit, me përjashtim të rasteve nga nenet 53, 55, 56 dhe 57 të këtij ligji.

Kompetenca në fazën e ndërhyrjes së hershme

Neni 50

Nëse plotësohen kushtet për intervenim të hershëm, në përputhje me ligjin që rregullon punën e bankave, Banka Popullore mund ta detyrojë bankën që të kontaktojë blerësit potencial për ta përgatitur bankën për ndërhyrje të jashtëzakonshme, duke respektuar në mënyrë të përshtatur parimet e nenit 27, paragrafi (2) të këtij ligji dhe dispozitat e konfidencialitetit të nenit 65 të këtij ligji.

Kompetenca për të kërkuar kryerjen e shërbimeve dhe shfrytëzimin e hapësirës dhe pajisjeve

Neni 51

(1) Banka Popullore ka të drejtë të marrë vendim me të cilin urdhëron bankën mbi të cilën bëhet ndërhyrja e jashtëzakonshme ose ndonjë anëtar tjetër të grupit bankar që t'i ofrojë shërbimet ose shfrytëzimin e hapësirës dhe pajisjeve që i nevojiten shoqërisë pranuese për kryerjen efikase të detyrave që i janë transferuar.

(2) Banka Popullore ka të drejtë të vendosë në përputhje me paragrafin (1) të këtij neni nëse është hapur procedurë falimentimi ndaj bankës që është në ndërhyrje të jashtëzakonshme ose ndaj një anëtari tjetër të grupit bankar.

(3) Ofrimi i shërbimeve dhe shfrytëzimi i hapësirës dhe pajisjeve në përputhje me këtë nen nuk përfshin asnjë mbështetje financiare.

(4) Shërbimet kryhen, përkatësisht hapësira dhe pajisjet shfrytëzohen në këto kushte:

1) nëse shërbimet ose hapësira dhe pajisjet i janë ofruar bankës që është duke u zgjidhur në përputhje me një kontratë menjëherë para ndërmarrjes së veprimeve të ndërhyrje të jashtëzakonshme, me të njëjtat kushte për kohëzgjatjen e asaj kontrate;

2) nëse nuk ka kontratë për kryerjen e shërbimeve ose shfrytëzimin e hapësirës dhe pajisjeve ose kontrata e tillë ka pushuar të jetë e vlefshme, në kushte të arsyshme.

(5) Banka Popullore vlerëson, varësisht nga rrethanat e secilit rast individual, nëse dhe cilat shërbime nevojiten për kryerjen e vazhdueshme të veprimtarisë së bartur, të drejtat dhe detyrimet, veçanërisht funksionet kritike.

(6) Kur vlerësohet nëse banka ndaj të cilës bëhet ndërhyrje e jashtëzakonshme ose një anëtar tjetër i grupit bankar duhet të urdhërohen të ofrojnë shërbime ose të mundësojnë përdorimin e hapësirës dhe pajisjeve, merren parasysh të paktën këto fusha: teknologjia e informacionit, burimet njerëzore, përpunimi/procesimi i transaksioneve, parandalimi i larjes të parave dhe financimit të terrorizmit, sigurimi i hapësirës për afarizëm, shërbime ligjore dhe respektimi i rregulloreve, administrimi i aseteve, administrimi i rrezikut, kontabilitetit, menaxhimit me para të gatshme.

(7) Sigurimi i shërbimeve nuk duhet të përfshijë marrjen e rreziqeve financiare që mund të paraqes mbështetje financiare në kundërshtim me paragrafin (2) të këtij neni.

Kompetencat në lidhje me mjetet, të drejtat, detyrimet, aksionet dhe instrumentet e tjera të pronësisë në vende të tjera

Neni 52

(1) Në rastet kur vendimi i bankës përfshin marrjen e veprimeve në lidhje me mjetet që ndodhen në një vend tjetër ose aksione, instrumente të tjera pronësore, të drejta ose detyrime për të cilat zbatohet ligji i një vendi tjetër, Banka Popullore ka të drejtë të urdhërojë me vendim si vijon:

1) drejtuesit e posaçëm të bankës mbi të cilën ndërhyhet në mënyrë të jashtëzakonshme dhe shoqëria marrëse të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për të realizuar transferimin, shlyerjen, shndërrimin në aksione ose veprimtari të tjera;

2) drejtuesit e posaçëm të bankës që vendos të disponojë aksione, instrumente të tjera pronësie, mjete ose të drejta ose të përmbushin detyrimet në emër të shoqërisë marrëse, derisa të kryhet transferimi, shlyerja, shëndërrimi ose veprimtari të tjera;

3) shpenzimet e arsyetuara të shoqërisë marrëse që kanë ndodhur gjatë ndërmarrjes së veprimeve nga pikat 1) dhe 2) të këtij paragrafi, të kompensohen në mënyrën e përcaktuar në nenin 24, paragrafi (6) të këtij ligji.

(2) Nëse Banka Popullore vlerëson se përkundër të gjitha veprimeve të ndërmarra nga drejtuesit e posaçëm në përputhje me paragrafin (1), pika 1) e këtij neni, ka pak gjasa që transferimi, shlyerja, shëndërrimi ose aktivitete të tjera të kryhen në lidhje me mjetet që ndodhen në një vend tjetër ose në aksione, instrumente të tjera pronësie, të drejta ose detyrime ndaj të

cilave ligji i një shteti tjetër nuk zbaton, transferon ose nuk zbaton veprimtaritë e tjera. Nëse tashmë është marrë një vendim për transferim, shlyerje, shëndrrim ose aktivitet tjetër, ai do të pushojë të vlej.

Përjashtimi i disa kushteve kontraktuese gjatë ndërhyrjes së jashtëzakonshme të një banke

Neni 53

(1) Zbatimi i masës për parandalimin e krizave, autorizimi për shtyrjen e pagesës ose përmbushjen e detyrimeve të nenit 54 të këtij ligji ose aplikimi i masës për menaxhimin e krizës, si dhe ndodhja e një ngjarjeje që lidhet drejtpërdrejt me zbatimin e këtyre masave dhe autorizimeve, në vetvehte nuk mund të konsiderohet shkelje e detyrimeve ose t'i japë palës kontraktuese:

1) të drejtën për të zgjidhur, shtyrë, modifikuar, kompensuar ose zgjidhur kontratën, duke përfshirë:

-kontratë të lidhur nga një filial i bankës, ku detyrimet e kontratës garantohen nga një person nga një grupi bankar ose

-kontratë e lidhur nga çdo person nga grupi bankar, ku kontrata përfshin dispozita të ndërlidhura me detyrimin (cross-default provisions);

2) e drejta për të fituar pronë, kontroll ose për të realizuar të drejtën e barrës mbi çdo pasuri të bankës që është në ndërhyrje të jashtëzakonshme ose të ndonjë personi nga grupi bankar, nëse kontrata përfshin dispozita për mospërmbushje të kryqëzuar të detyrimeve;

3) të drejtën për të ndikuar në çdo të drejtë kontraktuese të bankës mbi të cilën ndërhyhet në mënyrë të jashtëzakonshme ose të çdo personi nga grupi bankar, nëse kontrata përfshin dispozita për mospërmbushje të kryqëzuar të detyrimeve.

(2), paragrafi (1) të këtij neni vlen edhe për kontratat e lidhura me:

1) filialet e bankës, ku detyrimet sipas kontratës garantohen nga banka ose nga një person tjetër nga grupi bankar ose

2) çdo person nga grupi bankar, ku kontrata përfshin dispozita për mospërmbushje të kryqëzuar të detyrimeve (cross-default provisions).

(3) Dispozitat e paragrafëve (1) dhe (2) të këtij neni nuk cenojnë të drejtën e palës kontraktuese për të ndërmarrë veprimet të paragrafit (1) të këtij neni, nëse kjo e drejtë bazohet në një ngjarje që nuk është rezultat i zbatimit të masës për parandalimin e krizave ose masës për menaxhimin e krizës ose ngjarje që lidhet drejtpërdrejt me zbatimin e atyre masave.

(4) Shtyrja ose kufizimi nga nenet 54, 55, 56 dhe 57 të këtij ligji nuk konsiderohet si mospërmbushje e detyrimeve kontraktuese në kuptim të këtij neni të ligjit.

Autorizimi për të vonuar pagesën ose përmbushjen e detyrimeve përpara sjelljes së vendimit për fillimin e procedurës së ndërhyrjes së jashtëzakonshme mbi bankën

Neni 54

(1) Banka Popullore ka të drejtë të vendosë për shtyrjen e përkohshme të detyrimeve të pagesës ose përmbushjes së detyrimeve të tjera nga kontratat e lidhura nga banka, nëse plotësohen kushtet si në vijim:

1) gjendja në bankë është e tillë që ajo nuk mundet ose ka të ngjarë që nuk do të mund të vazhdojë të punojë;

2) nuk disponohet me asnjë masë tjetër në përputhje me nenin 19, paragrafi 1), pika 2) të këtij ligji që mund të pengojë ndërprerjen e veprimtarisë së bankës;

3) shtyrja konsiderohet e nevojshme për të parandaluar përkeqësimin e mëtejshëm të gjendjes financiare të bankës dhe

4) vonesa konsiderohet e nevojshme për të:

- vlerësuar ekzistencën e interesit publik ose

- ndërrmarjen e aktivitetit të duhur të ndërhyrje të jashtëzakonshme ose sigurimin e zbatimit efikas të një instrumenti të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

(2) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, vendimi për shtyrje nuk zbatohet për detyrimet e pagesës dhe përmbushjen e detyrimeve ndaj:

1) sistemeve të pagesave dhe sistemeve të shlyerjes së obligacioneve dhe operatorët e këtyre sistemeve;

2) palët tjera kontraktuese qendrore;

3) bankat qendrore.

(3) Banka Popullore me rastin e vendosjes për detyrimet të cilave do t'u referohet vendimi të paragrafit (1) të këtij neni, i merr parasysh rrethanat e secilit rast individual dhe vlerëson se a është e përshtatshme që vendimi të zbatohet edhe për depozitat e pranueshme në bankë, e veçanërisht për depozitat e mbuluara.

(4) Nëse vendimi i Bankës Popullore të paragrafit (1) të këtij neni zbatohet edhe për depozitat e pranueshme, me të caktohet shuma përkatëse ditore e atyre depozitave e cila u vihet në disponueshmëri depozituesve.

(5) Banka Popullore shpall njoftimin për vendimin e marrë të paragrafit (1) të këtij neni në mënyrën e përcaktuar në nenin 22, paragrafi (8) të këtij ligji.

(6) Banka është e detyruar të publikojë në faqen e saj të internetit njoftimin për vendimin e marrë të paragrafit (1) të këtij neni.

(7) Shtyrja vlen nga momenti i shpalljes së shtyrjes, në përputhje me paragrafin (5) të këtij neni dhe zgjat aq sa është e nevojshme për arritjen e objektivave të paragrafit (1), pikat 3) dhe 4) të këtij neni, ndërsa më së voni deri në mesnatë ditën e ardhëshme pas shpalljes të paragrafit (5) të këtij neni.

(8) Me rastin e aplikimit të autorizimit nga ky nen, Banka Popullore i merr parasysh efektet e mundshme në funksionimin normal të tregjeve financiare, si dhe të drejtat e kreditorëve në procedurën e falimentimit të një banke në përputhje me parimet e nenit 18, paragrafi (1), pikat 7) dhe 8) të këtij ligji.

(9) Nëse detyrimet e pagesës dhe përmbushja e detyrimeve tjera kontraktuese të bankës shtyhen në përputhje me paragrafin (1) të këtij neni, për të njëjtën periudhë shtyhen detyrimet e pagesës dhe përmbushja e detyrimeve tjera të palës tjetër kontraktuese nga ajo kontratë.

(10) Detyrimi për pagimin ose përmbushjen e një detyrimi tjetër që do të mbaronte gjatë periudhës së vonesës, bëhet menjëherë pas skadimit të atij afati.

(11) Për vendimin të paragrafit (1) të këtij neni, Banka Popullore pa vonesë e njofton bankën të cilës i referohet vendimi, Fondin për sigurimin e depozitave/Fondin për ndërhyrje të jashtëzakonshme bankare, Ministrinë e financave, organin kompetent për mbikëqyrje dhe organin kompetent për ndërhyrje të jashtëzakonshme të nenit 19, paragrafi (9) alineat 2, 3 dhe 4 nga ky ligj.

(12) Me vendimin të paragrafit (1) të këtij neni, Banka Popullore, mundet për kohëzgjatjen e shtyrjes, njëkohësisht:

1) të kufizojë të drejtën e kreditorëve të bankës për të filluar realizimin e sigurisë në lidhje me ndonjë nga mjetet e bankës, duke zbatuar dispozitat e nenit 56, paragrafët (3) dhe (4) të këtij ligji;

2) t'ia shtyjë të drejtën palës tjetër kontraktuese për t'a shkëputur kontratën e lidhur me bankën, me çka do të zbatohen dispozitat e nenit 57, paragrafët (4) deri (8) të këtij ligji.

(13) Nëse pas marrjes së vendimit të paragrafit (1) të këtij neni, Banka Popullore ka marrë vendim për fillimin e procedurës së ndërhyrjes së jashtëzakonshme mbi bankën, ndaj asaj banke nuk mund t'i zbatoj kompetencat nga nenet 55, 56 dhe 57 të këtij ligji.

Autorizimi për vonesën e pagesës dhe përmbushjen e detyrimeve pas sjelljes së vendimit për fillimin e procedurës së ndërhyrjes së jashtëzakonshme mbi bankën

\
 Neni 55

(1) Banka Popullore ka të drejtë të marrë vendim për shtyrjen e përkohshme të detyrimeve të pagesës ose përmbushjes së detyrimeve tjera nga kontratat e lidhura nga banka që është në ndërhyrje të jashtëzakonshme. Banka Popullore e publikon njoftimin për vendimin e miratuar në mënyrën e përcaktuar në nenin 22, paragrafi (8) të këtij ligji.

(2) Shtyrja vlen nga momenti i shpalljes së shtyrjes, në përputhje me paragrafin (1) të këtij neni dhe zgjat deri në mesnatë të ditës së ardhshme të punës pas shpalljes të paragrafit (1) të këtij neni.

(3) Detyrimi për pagimin ose përmbushjen e një detyrimi tjetër që do të mbaronte gjatë periudhës së vonesës, bëhet menjëherë pas skadimit të atij afati.

(4) Nëse detyrimet për pagesë dhe përmbushja e detyrimeve tjera kontraktuese të bankës që janë në ndërhyrje të jashtëzakonshme shtyhen në përputhje me paragrafin (1) të këtij neni, për të njëjtën periudhë shtyhen detyrimet e pagesës dhe përmbushja e detyrimeve tjera të palës tjetër kontraktuese nga ajo kontratë.

(5) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, vendimi për shtyrje të përkohshme nuk vlen për detyrimet e pagesës dhe përmbushjen e detyrimeve ndaj:

1) sistemit të pagesave dhe sistemit së shlyerjes së obligacioneve dhe operatorët e këtyre sistemeve;

2) palët tjera kontraktuese qendrore;

3) bankat qendrore.

(6) Me rastin e zbatimit të autorizimit nga ky nen, Banka Popullore i merr parasysh efektet e mundshme në funksionimin normal të tregjeve financiare.

(7) Sipas rrethanave të secilit rast individual, Banka Popullore vlerëson nëse është e përshtatshme që autorizimi të paragrafit (1) të këtij neni të zbatohet edhe për depozitat e pranueshme në bankë, e veçanërisht për depozitat e mbuluara. Në vendimin e Bankës Popullore me të cilin autorizimi të paragrafit (1) të këtij neni zbatohet për depozitat e pranueshme, mund të përcaktohet shuma e duhur ditore e atyre depozitave e cila vihet në dispozicion të depozituesve.

Autorizim për kufizimin e të drejtës për realizimin e sigurisë

Neni 56

(1) Banka Popullore ka të drejtë të marrë vendim me të cilin përkohësisht u kufizohet e drejta e kreditorëve të bankës që vendos të fillojë realizimin e garancisë në lidhje me cilat do mjete të bankës. Banka Popullore e publikon njoftimin për vendimin e miratuar në mënyrën e përcaktuar me nenin 22, paragrafi (8) të këtij ligji.

(2) Kufizimi vlen nga momenti i shpalljes së kufizimit në përputhje me paragrafin (1) të këtij neni deri në mesnatën e ditës së ardhshme të punës pas shpalljes të paragrafit (1) të këtij neni.

(3) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, vendimi për kufizim të përkohshëm nuk vlen për:

1) sigurimin e sistemeve të pagesave dhe sistemeve të shlyerjes së obligacioneve dhe operatorëve të këtyre sistemeve;

2) palët e tjera kontraktuese qendrore dhe

3) bankat qendrore, në lidhje me mjetet e lëna peng nga banka që po zgjidhet.

(4) Në rastet e nenit 64 të këtij ligji, Banka Popullore do të ketë parasysh nëse kufizimet e autorizimeve të paragrafit (1) të këtij neni janë të njëjta për të gjithë anëtarët e grupit në lidhje me veprimet e ndërmarra për ndërhyrje të jashtëzakonshme ndaj problemit.

(5) Në rast aplikimi për autorizim, Banka Popullore do të marrë në konsideratë efektin e mundshëm në funksionimin normal të tregjeve financiare.

Autoritetet të pezullojnë përkohësisht të drejtën për ndërhyrje të jashtëzakonshme ndajnjë kontrate

Neni 57

(1) Banka Popullore ka të drejtë të marrë vendim me të cilin i'a shtyn përkohësisht të drejtën palës tjetër kontraktuese që të zgjidh kontratën e lidhur me bankën që shlyhet, me kusht që të vazhdojnë të përmbushen detyrimet për pagesën dhe dorëzimin, si dhe për sigurimin në përputhje me kontratën.

(2) Banka Popullore shpall njoftimin për vendimin e miratuar në mënyrën e përcaktuar në nenin 22, paragrafi (8) të këtij ligji.

(3) Shtyrja nga paragrafët (1) dhe (4) të këtij neni vlen nga momenti i shpalljes së shtyrjes deri në mesnatë të ditës së ardhshme të punës pas shpalljes të paragrafit (1) të këtij neni.

(4) Autorizimi të paragrafit (1) të këtij neni mund t'i referohet edhe kontratës që pala tjetër kontraktuese e ka lidhur me filialin e bankës që shlyhet, nëse:

1) për përmbushjen e detyrimeve të kontratës garantohet ose parashikohet ndryshe nga banka që shlyhet;

2) e drejta për ndërhyrje të jashtëzakonshme ndaj kontratës varet ekskluzivisht nga aftësia paguese ose gjendja financiare e bankës mbi të cilën ndërhyhet në mënyrë të jashtëzakonshme dhe

3) gjatë bartjes së pasurisë, të drejtave ose detyrimeve të bankës, e cili zgjidhet në përputhje me këtë ligj, të gjitha mjetet, të drejtat dhe detyrimet e filialit në lidhje me kontratën barten ose mund t'i barten shoqërisë pranuese ose Banka Popullore i siguron ato detyrime në mënyrë tjetër.

(5) Me përjashtim të paragrafëve (1) dhe (4) të këtij neni, vendimi për shtyrje të përkohshme nuk ka të bëjë me:

1) sistemet e pagesave dhe sistemet e shlyerjes së obligacioneve dhe operatorët e këtyre sistemeve;

2) palët tjera kontraktuese qendrore;

3) bankat qendrore.

(6) Me përjashtim nga paragrafët (1) deri (5) të këtij neni, pala kontraktuese mund t'a zgjidhë kontratën para përfundimit të periudhës në të cilën është e vlefshme shtyrja, nëse merr njoftim nga Banka Popullore se mjetet, të drejtat ose detyrimet e parashikuara nga kontrata nuk do t'i barten shoqërisë marrëse ose nuk do të shlyhen ose shëndrohen në aksione gjatë aplikimit të instrumentit për shpërndarje të brendëshme të humbjeve.

(7) E drejta për ndërhyrje të jashtëzakonshme ndajkontratës nga paragrafët (1) dhe (4) të këtij neni mund të ushtrohet pas përfundimit të afatit të shtyrjes, në përputhje me nenin 53 të këtij ligji, në këtë mënyrë:

1) nëse të drejtat dhe detyrimet e përfshira në kontratë i barten shoqërisë pranuese, pala tjetër kontraktuese mund ta zgjidhë kontratën vetëm nëse pas bartjes lindin kushtet për ndërhyrje të jashtëzakonshme ndajkontratës;

2) nëse të drejtat dhe detyrimet e përfshira në kontratë mbeten me bankën që është në ndërhyrje të jashtëzakonshme, dhe Banka Popullore nuk e ka aplikuar instrumentin për shpërndarjen e brendshme të humbjeve, pala tjetër kontraktuese mund ta ndërpresë kontratën nëse pas kalimit të afatit për shtyrje lindin kushte për shkëputjen e kontratës.

(8) Me rastin e zbatimit të autorizimit nga ky nen, Banka Popullore i merr parasysht efektet e mundshme në funksionimin normal të tregjeve financiare.

Njohja kontraktuese e kompetencave të vonesës dhe kufizimit në kontratat financiare për të cilat zbatohet ligji i një vendi tjetër

Neni 58

(1) Banka është e detyruar të sigurojë që kontrata financiare për të cilën zbatohet ligji i një vendi tjetër të përmbajë dispozita që parashikojnë se të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga ajo marrëdhënie kontraktuese mund t'i nënshtrohen vonesës ose kufizimit në përputhje me nenet 54, 55, 56 dhe 57 të këtij ligji dhe se ndaj tyre zbatohen edhe dispozitat e nenit 53 të këtij ligji.

(2), paragrafi (1) të këtij neni zbatohet për çdo kontratë financiare e cila:

1) krijon një detyrim të ri ose ndryshon ndjeshëm detyrimin ekzistues pas hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe

2) parasheh ushtrimin e së drejtës për ndërprerjen ose realizimin e garancisë, për të cilën do të zbatoheshin nenet 53 deri në 57 nga ky ligj, nëse kontrata financiare do të rregullohej në përputhje me të drejtën pozitive e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(3) Pavarësisht nëse kontrata financiare përmban dispozita në përputhje me paragrafin (1) të këtij neni, Banka Popullore mund t'i ushtrojë kompetencat nga nenet 53 deri në 57 të këtij ligji lidhur me atë kontratë financiare.

Ushtrimi i autorizimeve për ndërhyrje të jashtëzakonshme

Neni 59

(1) Banka Popullore gjatë zbatimit të punëve për ndërhyrje të jashtëzakonshme mund të ushtrojë kontroll mbi bankën që është në ndërhyrje të jashtëzakonshme, në atë mënyrë që:

1)drejton bankën, e cila ka të gjitha kompetencat e aksionarëve, këshillit drejtues dhe këshillit mbikëqyrës si dhe

2)drejton dhe disponon me mjetet e bankës që është në ndërhyrje të jashtëzakonshme. (2) Banka Popullore mund t'a ushtroj kontrollin të paragrafit (1) nga ky nen drejtpërdrejt ose përmes personave të caktuar nga Banka Popullore.

(3) Të drejtat e votës nga aksionet e bankës që janë në ndërhyrje të jashtëzakonshme nuk mund të ushtrohen derisa procedura e ndërhyrjes së jashtëzakonshme të bankës është në proces.

(4) Banka Popullore mund të ndërmarrë aktivitete të ndërhyrjes së jashtëzakonshme përmes akteve administrative individuale nën kompetencën e saj, pa ushtruar kontroll mbi bankën që është në ndërhyrje të jashtëzakonshme.

KAPITULLI VII MASAT MBROJTËSE

Trajtimi me aksionerët dhe kreditorët gjatë transferimit të pjesshëm dhe aplikimit të instrumentit të shpërndarjes së brendshme të humbjeve

Neni 60

(1) Në rastet kur Banka Popullore, duke aplikuar një ose më shumë instrumente për ndërhyrje të jashtëzakonshme bankare, transferon një pjesë të pasurisë, të drejtave dhe detyrimeve të bankës që janë në ndërhyrje të jashtëzakonshme, aksionarët dhe kreditorët, huat e të cilëve nuk u janë bartur si kompensim për huat e tyre, marrin së paku shumën që do ta kishin marrë nëse në kohën kur është marrë vendimi të nenit 22 të këtij ligji, do të ishte hapur falimentimi ndaj bankës.

(2) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, në rastet kur Banka Popullore e aplikon instrumentin për shpërndarjen e brendshme të humbjeve, aksionarët dhe kreditorët, huat e të cilëve janë shlyer ose shndërruar në aksione, nuk realizojnë humbje më të mëdha se ato që do të kishin nëse në kohën kur është marrë vendimi të nenit 22 të këtij ligji, ndaj bankës do të hapej procedura e falimentimit.

Vlerësim i pavarur i humbjeve ndaj aksionarëve dhe kreditorëve

Neni 61

(1) Për të konstatuar nëse aksionarët dhe kreditorët e bankës që është në ndërhyrje të jashtëzakonshme do të ishin në pozitë më të favorshme nëse për bankën hapej procedura e falimentimit, Banka Popullore jep vlerësim të pavarur të vlerës, sa më shpejt që të jetë e mundur pas ndërmarrjes së veprimeve për ndërhyrjen e jashtëzakonshme mbi bankën.

(2) Vlerësimin mund ta bëjë vetëm vlerësuesi i pavarur i cili i plotëson kushtet të nenit 21, paragrafi (1) të këtij ligji. Nëse vlerësimi kryhet nga një vlerësues i pavarur që ka bërë vlerësimin e pavarur të vlerës të nenit 21 të këtij ligji, këto dy vlerësime duhet të jenë të ndryshme.

(3) Vlerësimi duhet të përcaktojë:

1)humbjet që do të kishin aksionarët, kreditorët dhe Fondi i Sigurimit të Depozitave nëse në momentin e marrjes së vendimit për fillimin e procedurës së ndërhyrjes së jashtëzakonshme mbi bankën do të hapej procedura e falimentimit ndaj bankës;

2)humbjet që kanë pësuar aksionarët dhe kreditorët e bankës në procedurën e ndërhyrjes së jashtëzakonshme të bankës; dhe

3)diferenca e mundshme në shumën e humbjeve nga pikat 1) dhe 2) të këtij paragrafi.

(4) Vlerësimi bazohet në supozimin se:

1)ndaj bankës është hapur procedura e falimentimit e cila është duke u zgjidhur në momentin e marrjes së vendimit të nenit 22 të këtij ligji;

2)nuk janë ndërmarrë veprime për ndërhyrjen e jashtëzakonshme mbi bankën; dhe

3)banka nuk është miratuar për ndihmë të jashtëzakonshme financiare publike.

(5) Këshilli i Bankës Popullore me akt nënligjor më hollësisht e përcakton mënyrën e kryerjes së vlerësimit të pavarur nga ky nen.

Masat mbrojtëse ndaj aksionarëve dhe kreditorëve

Neni 62

(1) Nëse nga vlerësimi të nenit 61 të këtij ligji përcaktohet se në procedurën e ndërhyrjes së jashtëzakonshme të bankës çdo aksionar, kreditor ose Fondi i sigurimit të depozitave në rastet e nenit 79, paragrafi (1) nga ky ligj, ka pasur humbje më të mëdha se ato që do të kishin në procedurën e falimentimit ndaj bankës, ata persona kanë të drejtën e kompensimit për diferencën nga fondet e rizgjedhjes së bankës.

Mbrojtja e palës tjetër kontraktuese në transferimet e pjesshme

Neni 63

(1) Nëse Banka Popullore një pjesë të mjeteve, të drejtave dhe detyrimeve të bankës mbi të cilën ndërhyhet në mënyrë të jashtëzakonshme, nga institucioni kalimtar ose nga shoqëria për administrimin e mjeteve i'a bart personit tjetër, ose nëse zbaton autorizimin të nenit 48, paragrafi (2), pika 6) të këtij ligji, kontratat, aranzhimet dhe instrumentet në vijim i nënshtrohen mbrojtjes përkatëse:

1)kontrata për sigurim financiar me barrë;

2)kontrata e sigurimit financiar me kalimin e pronësisë;

3)kontrata/deklaratat për kompensimin e dy ose më shumë huave ose detyrimeve ndërmjet bankës që shlyhet dhe palës tjetër kontraktuese;

4)kontratat me rrjetë;

5)obligacionet të mbuluara;

6)kontratat për financimin e strukturuar, duke përfshirë obligacionet dhe instrumentet e përdorura për të mbrojtur nga rreziqet që janë pjesë përbërëse e një grupi aktivesh kolaterale dhe të cilat, në përputhje me rregulloret në fuqi, janë të siguruara në mënyrë të ngjashme si obligacionet të mbuluara, mbi bazën e të cilave një palë ose përfaqësues ose përfaqësues fiton ose mban një vlerë.

(2) Mbrojtja në përputhje me paragrafin (1) të këtij neni zbatohet pavarësisht nga numri i palëve kontraktuese në kontratë dhe pa marrë parasysh:

1)nëse marrëdhëniet juridike kanë lindur në bazë të kontratës, me kalimin e së drejtës së pronësisë për qëllim të sigurimit ose në një mënyrë tjetër, ose nëse kanë lindur në bazë të ligjit;

2)nëse në ato marrëdhënie juridike zbatohet tërësisht ose pjesërisht ligji i një vendi tjetër.

(3) Banka Popullore nuk mund të kryejë bartje të pjesshme të të drejtave dhe detyrimeve për të cilat është përcaktuar me kontratë për sigurim financiar me kalimin e pronësisë, kontratë/deklaratë për kompensim ose kontratë neto të lidhur nga banka se ato mund të jenë objekt i kompensimit ose netos, as nuk mund të kërkojë ndryshim ose ndërprerje të vlefshmërisë së këtyre të drejtave dhe detyrimeve kontraktuale.

(4) Në kuptim të paragrafit (3) të këtij neni, konsiderohet se të drejtat dhe detyrimet mbrohen me kontrata ose aranzhime të tilla, nëse palët e tyre kontraktuese janë të autorizuar për të kryer kompensimin ose shlyerjen e atyre të drejtave dhe detyrimeve.

(5) Në lidhje me detyrimet nga marrëveshjet për sigurim financiar me barrë, Banka Popullore nuk mund:

1) të transferoj mjetet që janë dhënë si garanci për detyrimin, nëse nuk barten njëkohësisht edhe detyrimi edhe dobia nga sigurimi

2) bartja e detyrimeve të siguruara, nëse përfitimi nga letra me vlerë nuk bartet në të njëjtën kohë;

3) të transferohet përfitimi nga letra me vlerë, nëse detyrimi i siguar nuk bartet në të njëjtën kohë;

4) të ndryshohet ose të shkëputet kontrata për sigurim financiar me të drejtë të zotuar nëse si rrjedhojë pushon së siguruari detyrimi.

(6) Banka Popullore nuk mund të kryejë bartje të pjesshme të të drejtave dhe detyrimeve që janë objekt i kontratës së strukturuar financimi ose bartje të pjesshme të obligacioneve të mbuluara, as nuk mund t'i ndryshojë ose t'i shfuqizojë të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin prej tyre.

(7) Me përjashtim të paragrafëve (3), (4), (5) dhe (6) të këtij neni, për të siguar disponueshmërinë e depozitave të mbuluara, Banka Popullore mund:

1) të transferojë depozitat e mbuluara që i nënshtrohen ndonjërisht prej kontratave dhe aranzhimeve nga paragrafët (3), (4), (5) dhe (6) të këtij neni pa transferuar njëkohësisht mjete të tjera, të drejta dhe detyrime që janë objekt i së njëjtës kontratë dhe

2) të transferojë, modifikojë ose anulojë ato mjete, të drejta ose detyrime pa transferuar njëkohësisht depozitat e mbuluara.

(8) Këshilli i Bankës Popullore më hollësisht i përcakton llojet e kontratave, aranzhimeve dhe instrumenteve që janë objekt i mbrojtjes në përputhje me paragrafin (1) të këtij neni.

Mbrojtja e sistemeve të tregtimit, kleringut dhe ndërhyrjes së jashtëzakonshme gjatë transmetimeve të pjesshme

Neni 64

(1) Aplikimi i instrumenteve për ndërhyrje të jashtëzakonshme bankare nuk guxon të ndikojë në funksionimin dhe rregullat e sistemeve të rregulluara me rregulloret me të cilat rregullohet përfundimi i ndërhyrje të jashtëzakonshmeve në sistemet e pagesave dhe sistemet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme të obligacioneve, në rastet kur Banka Popullore:

1) kryen një transferim të pjesshëm të mjeteve, të drejtave dhe detyrimeve nga banka që shlyhet te një person tjetër ose

2) duke zbatuar kompetencat shtesë, zgjidh kontratën ose ndryshon kushtet e kontratës së lidhur nga banka që shlyhet ose siguron që shoqëria marrëse të zërë vendin e saj si palë kontraktuese.

(2) Me kalimin, ndryshimin ose ndërprerjen të paragrafit (1) të këtij neni, urdhri për transferim nuk mund të revokohet, nuk pengohet zbatimi i urdhrit për transferim dhe netingun, shfrytëzimi i mjeteve, obligacioneve dhe kredive, në përputhje me ligjin që rregullon shërbimet e pagesave dhe ligjin.

KAPITULLI VIII KONFIDENCIALITETI, BASHKËPUNIMI DHE SHKËMBIMI I INFORMACIONEVE, MIRËNJOHJA DHE PËRGJEGJËSIA PËR DËMIN

Konfidencialiteti

Neni 65

(1) Informacionet dhe të dhënat e marra dhe krijuara në lidhje me veprimet e ndërhyrjes së jashtëzakonshme të bankave të cilat ndërrmeren në përputhje me këtë ligj konsiderohen konfidenciale.

(2) Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit të informatave dhe të dhënave të paragrafit (1) të këtij neni vlen për personat në vijim:

1) punonjësit e Bankës Popullore si organ kompetent për shlyerje dhe mbikëqyrje dhe anëtarët e Këshillit të Bankës Popullore;

2) punonjës të Ministrisë së Financave;

3) të punësuarit e Fondit të sigurimit të depozitave dhe Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme të bankave;

4) drejtuesit e posaçëm të emëruar në përputhje me këtë ligj;

5) blerësit/themeluesit e mundshëm të aksioneve, mjeteve, të drejtave ose detyrimeve nga banka në ndërhyrje të jashtëzakonshme, të cilët kanë marrë informacion konfidencial nga Banka Popullore dhe punonjësit e tyre, pavarësisht nëse transferimi është kryer apo jo;

6) punonjësit e shoqërive të auditimit, konsulentët juridikë, vlerësuesit dhe ekspertët tjerë, të cilët drejtpërdrejt ose tërthorazi janë punësuar nga Banka Popullore, Ministria e Financave ose blerësi potencial nga pika 5) e këtij paragrafi;

7) punonjës të institucionit kalimtar ose të shoqërisë administruese të mjeteve;

8) punonjësit e tjerë të Bankës Popullore dhe punonjësit e autoriteteve të tjera që janë të përfshirë drejtpërdrejt ose tërthorazi në ndërhyrje të jashtëzakonshme e bankës dhe

9) persona të tjerë, të cilët drejtpërdrejt ose tërthorazi, në mënyrë të përhershme ose të përkohshme, ofrojnë ose u kanë ofruar shërbime personave nga pika (1), (2), (3), (4), (5), (6), (7) dhe pika (8) e këtij paragrafi, si dhe anëtarët e organeve drejtuese të personave nga pikat (1), (2), (3), (4), (5), (6), (7) dhe deri në pikën (8) të këtij paragrafi, nëse nuk përfshihen në këto pika.

(3) Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit të informatave dhe të dhënave të paragrafit (1) të këtij neni i referohet periudhës gjatë dhe pas emërimit, përkatësisht pas punësimit të personave të paragrafit (2) të këtij neni.

(4) Për të siguruar respektimin e detyrimeve të konfidencialitetit nga paragrafët (1) dhe (3) të këtij neni, personat juridik të paragrafit (2), pika 1), 2), 3), 7) dhe 8) të këtij neni, si dhe

institucioni kalimtar dhe shoqëria për administrimin e pasurisë, janë të detyruara të miratojnë dhe zbatojnë rregulla të brendshme në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit të informacioneve dhe të dhënave të paragrafit (1) të këtij neni.

